




UNODC

United Nations Office on Drugs and Crime



BIZNESI, KORRUPSIONI DHE KRIMI NË KOSOVË:

Ndikimi i ryshfetit dhe i krimit tjetër në ndërmarrjet private

2013



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

With funding from
the European Union



ZYRA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR DROGË DHE KRIM
Vjenë

Biznesi, Korrupsioni dhe Krimi në Kosovë:
Ndikimi i ryshfetit dhe i krimit tjetër në ndërmarrjet private

2013



UNODC

United Nations Office on Drugs and Crime

Falënderime

Ky raport është përgatitur nga Sektori i Statistikave dhe Anketave i UNODC-së

Koordinimi i hulumtimit dhe përgatitja e raportit:

Enrico Bisogno (SASS)

Michael Jandl (SASS)

Lucia Motolinía Carballo (SASS)

Felix Reiterer (SASS)

Hulumtimi në terren:

Muhamet Kastrati (Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Bashkim Bellaqa (Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Isa Krasniqi (Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Ibrahim Rrustemi (Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Sanije Ismajli (Agjencia e Statistikave të Kosovës)

Bashkëpunëtorë të projektit:

Iniciativa Rajonale Anti-Korrupsion për Evropën Juglindore (RAI), Transcrime.

Dizajni i kopertinës:

Suzanne Kunnen (RAB)

Mbikëqyrja:

Sandeep Chawla (Drejtor, Divizioni i Analizës së Politikave dhe Çështjeve Publike) dhe Angela Me (Udhëheqëse e Degës për Hulumtime dhe Analiza të Trendeve)

Me mirënjohje është pranuar kontributi i çmuar i Giulia Mugellini për zhvillimin e metodologjisë së anketës.

Të gjitha anketat e kryera dhe raportet janë përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe qeverive të Gjermanisë, të Norvegjisë dhe të Suedisë. Falënderime të sinqerta janë shprehur për Roberta Cortese (Komisioni Evropian) për mbështetjen e saj të vazhdueshme.

Abdikim

Ky raport nuk është redaktuar zyrtarisht. Përmbajtjet e këtij publikimi nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet a politikat e UNODC-së, ose të organizatave kontribuese, dhe as nuk nënkuptojnë ndonjë aprovim.

Emërtimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në këtë publikim nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë opinioni nga ana e UNODC-së, në lidhje me statusin ligjor të ndonjë vendi, territori a qyteti, ose të autoriteteve të tij, ose në lidhje me përcaktimin e kufijve të tij shtetërorë a administrativë.

Të gjitha referencat për Kosovën, në publikimin aktual, duhet kuptuar të jenë në kuadër të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

Foto: Fotografitë janë përdorur vetëm për ilustrim dhe nuk janë marrë në kontekstin e korrupsionit

©shutterstock



Përmbajtja

Falënderime	2
Përmbajtja.....	3
Përmbledhje e përgjithshme	5
Gjetjet kryesore	9
Hyrje.....	11
1. Përhapja e ryshfetit	15
2. Natyra e ryshfetit.....	21
3. Zyrtarët publikë dhe ryshfetet.....	29
4. Raportimi i ryshfetit.....	33
5. Ryshfeti biznes-me-biznes.....	37
6. Perceptimet dhe opinionet lidhur me korrupsionin	43
7. Përhapja dhe modelet e formave të tjera të krimit	49
8. Vërejtjet përfundimtare	63
Shtojca I: Konteksti ekonomik i korrupsionit të biznesit në Kosovë	67
Shtojca II: Metodologjia	71
Shtojca III: Treguesit kryesorë	75



Përmbledhje e përgjithshme

Kjo anketë e bizneseve private në Kosovë nxjerr në pah se korrupsioni dhe format e tjera të krimit janë një pengesë e madhe për ndërmarrjet private, dhe se kanë një efekt negativ në investimet private. Një përqindje e konsiderueshme e bizneseve iu paguajnë ryshfet zyrtarëve publikë, në mënyrë të përsëritur, gjatë gjithë vitit. Bizneset, në sektorët e prodhimit industrial, të furnizimit me energji elektrike, gaz dhe ujë, janë më të prekurit nga ryshfeti, të pasuar nga bizneset në sektorin e tregtisë me shumicë dhe të tregtisë me pakicë. Zyrtarët publikë, me rrezik më të lartë të ryshfetit në bashkëveprim me bizneset, janë: zyrtarët e doganave, zyrtarët tatimorë/të hyrave, zyrtarët komunalë ose provincialë.

Përderisa, treguesit e perceptimeve të korrupsionit, padyshim janë të dobishëm për ngritjen e ndërgjegjësimit, kjo anketë e mat përvojën aktuale të korrupsionit dhe krimit përmes anketave me përfaqësues të bizneseve, të bazuara në mostër, në mënyrë që të sigurojë një vlerësim më real, një vlerësim të korrupsionit dhe krimit, që prekin sektorin e biznesit, që është i bazuar në prova. Duke vepruar kështu, anketa përqendrohet në masën dhe modelin e ryshfetit sipas bizneseve, nga pesë sektorë të ndryshëm (të llogaritur për rreth 79.7% të të gjitha bizneseve në Kosovë) në bashkëveprimet e tyre të shpeshta me administratën publike.

Sipas anketës, nga të gjitha bizneset, që kanë pasur kontakt me një zyrtar publik, në 12 muajt para anketës, 3.2% e tyre i kanë paguar ryshfet një zyrtari publik. Përhapja mesatare e ryshfetit të biznesit në Kosovë është më e ulët sesa përqindja e qytetarëve të zakonshëm të Kosovës (11.1%), të cilët janë sprovuar me të njëjtën gjë në Anketën e UNODC-së, të vitit 2011, për popullsinë e përgjithshme¹.

Shqyrtimi i përvojës së bizneseve, që iu paguajnë ryshfet zyrtarëve publikë thekson faktin se korrupsioni luan një rol në biznesin e përditshëm të shumë kompanive. Bizneset ryshfetpaguese paguajnë mesatarisht 7.7 ryshfete në vit, ose rreth një ryshfet në gati çdo shtatë javë. Përhapja e ryshfetit është më e lartë kryesisht në mesin e bizneseve të mesme dhe të mëdha (me mbi 50 të punësuar) sesa në mesin e bizneseve të madhësive të tjera.

¹Të dhënat që i referohen ryshfetit, nga ana e individëve dhe ekonomive familjare, janë marrë nga studimi i fundit i UNODC-së, *Korrupsioni në Kosovë: ryshfeti siç është sprovuar nga popullsia (2011)*.

Një përqindje e konsiderueshme e gjithë ryshfetit, që u është paguar zyrtarëve publikë, nga bizneset në Kosovë, është paguar në para të gatshme (59.2%), pasuar me sigurimin e ushqimit dhe pijeve, në këmbim të një “favori” të paligjshëm nga ana e zyrtarit publik (58.4%) dhe të mira ose përfitime të tjera (12.1%). Kur ryshfeti është paguar me para të gatshme, shumica mesatare e paguar për ryshfet është 844 Euro, ose ekuivalente e 1,787 EUR-PFB.

Sa i përket asaj se cila palë, në fakt e inicion çështjen e ryshfetit, në rreth 38% të të gjitha rasteve, pagesa e ryshfetit është ofruar nga një përfaqësues i biznesit, pa bërë një kërkesë paraprake. Ndërsa, në gjysmën e rasteve (rreth 50.1%), pagesa është kërkuar nga zyrtari publik, qoftë në mënyrë eksplicite (13.3%) qoftë në mënyrë implicite (30.3%). Në 6.5% të rasteve të tjera, ryshfeti është paguar pas kërkesës së palës së tretë.

Qëllimet më të shpeshta të pagesës së ryshfetit, të cilat janë përmendur nga bizneset, janë: për t'i "përsheptuar procedurat lidhur me biznesin" (28.4% e gjithë ryshfetit); "marrja e një trajtimi më të mirë" (14.7%); dhe "mundësimi i finalizimit të procedurës" (13.1%). Në të njëjtën kohë, pothuajse një e katërta e ryshfetit të paguar (23.9%) nuk shërben për asnjë qëllim të veçantë të bizneseve, që e paguajnë atë. Këto lloje të ryshfetit konsiderohen si "ëmbëltues", që iu jepen zyrtarëve publikë për t'u "përkujdesur" për ta, gjatë bashkëveprimeve të ardhshme në interes të kompanisë.

Ndërsa, 3.7% e ryshfetit të paguar nga bizneset është raportuar te autoritetet zyrtare, kryesisht në polici, që tregon se bizneset në Kosovë shpesh ndihen të detyruar të marrin pjesë në ryshfet. Kjo është reflektuar edhe në arsyet kryesore, të përmendura, për mosraportimin e ryshfetit: "e pakuptimtë të raportohet pasi askujt nuk do t'i interesonte" (28.2%); "frika nga hakmarrja" (19.2%); dhe "pagesa ose dhurata është dhënë si një shenjë mirënjohjeje" (19.4%).

Ryshfeti në sektorin privat, jo vetëm që përfshin ryshfetin që bizneset ua paguajnë zyrtarëve publikë, por ajo gjithashtu ndodh edhe ndërmjet vetë bizneseve, në mënyrë që të sigurohen transaksionet e biznesit. Megjithatë, më e ulët sesa përhapja e ryshfetit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, me 0.6%, përhapja e ryshfetit biznes-me-biznes tregon se kjo praktikë ekziston në Kosovë. Ky lloj i korrupsionit nuk duhet të ngatërrohet me marketingun normal ose me aktivitetet e marrëdhënieve me publikun, në kuptimin që në mënyrë specifike synon, përmes mjeteve të paligjshme, ta shkelë integritetin e ryshfetmarrësit në këmbim të një ryshfeti. Asnjë nga bizneset në anketë nuk kanë raportuar, te autoritetet përkatëse, incidente të tilla të ryshfetit biznes-me-biznes.

Rreth 3.3% e përfaqësuesve të biznesit kanë vendosur që të mos bëjnë investim të madh në 12 muajt para anketës, për shkak të frikës se duhet të paguajnë ryshfet për t'i marrë shërbimet e kërkuara ose lejet. Kështu që, ndikimi i ryshfetit në aktivitetin e biznesit mund të jetë thelbësor.

Pasojat e krimeve të tjera, më tradicionale, në pronën e një biznesi dhe aktivitetet ekonomike, gjithashtu mund të jenë të konsiderueshme, si në aspektin e kostove të drejtpërdrejta, që rrjedhin nga dëmtimi fizik, po ashtu edhe në kostot indirekte në formën e premive të sigurimit, shpenzimet e sigurisë dhe mundësive për investime të humbura. Për shembull, rreth një në dhjetë biznese në Kosovë (10.1%) bien viktimë e vjedhjeve në aspekte të ndryshme (të llojllojshme) në një vit dhe bizneset e tilla janë të viktimizuar mesatarisht 1.9 herë në atë periudhë kohore.

Normat vjetore të përhapjes për mashtrim (8%) dhe vandalizëm (3.2%) në sektorin privat janë gjithashtu domethënëse. Të tilla janë numri mesatar i herave, që bizneset kanë rënë viktimë e këtyre krimeve (5.3 respektivisht 1.3). Për më tepër, gjatë 12 muajve të fundit, rreth 0.4% e të gjitha bizneseve në Kosovë kanë rënë viktimë e zhvatjes. Një krim ky, që mund të jetë i lidhur me grupet e organizuara kriminale.

Për dallim prej korrupsionit, një pjesë e madhe e krimeve të zakonshme (mesatarisht 59.3% për pesë lloje të krimit) është raportuar në polici nga bizneset në Kosovë. Përderisa, shumica e përfaqësuesve të biznesit (70.5%) konsiderojnë se rreziku nga krimi për kompaninë e tyre ka mbetur i qëndrueshëm në krahasim me 12 muajt e kaluar. Pothuajse, një në dhjetë (9.8%) mendojnë se krimi është në rritje dhe 16.2% mendojnë se është në rënie. Frika nga krimi luan një rol shumë të rëndësishëm në procesin e vendim-marrjes së udhëheqësve të biznesit, kur vjen puna për të bërë investime të mëdha. Megjithëse, ka disa dallime sipas sektorit ekonomik, mesatarisht 9.1% e ndërmarrësve në Kosovë deklarojnë se ata nuk kanë bërë investim të madh në 12 muajt e mëparshëm, për shkak të frikës nga krimi.

Megjithatë, rreth katër të pestat e bizneseve në Kosovë (80.4%) përdorin të paktën një sistem mbrojtës të sigurisë kundër krimit. Vetëm një e treta (33.5%) kanë ndonjë lloj të sigurisë kundër shpenzimeve ekonomike të krimit. Së bashku, korrupsioni dhe format e tjera të krimit, i vënë një barrë të konsiderueshme zhvillimit ekonomik në Kosovë. Vënia në vend e masave më të shumta dhe më të mira, të synuara për mbrojtjen e bizneseve kundër krimeve, si dhe për parandalimin e korrupsionit (të tilla si masat efektive të pajtueshmërisë së brendshme dhe politikat e tjera lidhur me korrupsionin) do të mund ta bënin atë, në mënyrë të konsiderueshme, barrë më të lehtë.



Gjetjet kryesore

- Përfaqësuesit e biznesit në Kosovë e radhisin korrupsionin si pengesën më të madhe për të bërë biznes, pasuar nga taksat e larta dhe mungesa e stabilitetit politik.
- Nëntë nga dhjetë kompani kanë pasur të paktën një kontakt të drejtpërdrejtë me një zyrtar publik ose me një shërbyes civil, në 12 muajt para anketës.
- Norma e përhapjes së ryshfetit në mesin e atyre bizneseve, që kanë pasur kontakt me zyrtarë publikë në atë periudhë është 3.2%.
- Bizneset që paguajnë ryshfet kanë paguar një mesatare prej 7.7 të ryshfetit për zyrtarët publikë, në 12 muajt para anketës.
- Ekzistojnë disa variacione në përhapjen e ryshfetit nëpër sektorët e biznesit në Kosovë: në prodhim industrial, energji elektrike, gaz dhe ujë (4.8%); në tregti me shumicë dhe tregti me pakicë (3.3%); në akomodim dhe aktivitete për shërbime të ushqimit (2.9%); në ndërtimtari e transport dhe magazinim të kombinuar (1.6%).
- Në Kosovë, 59.2% e ryshfetit është paguar me para të gatshme. Shuma mesatare e paguar për ryshfet është 844 Euro, e cila korrespondon me 1,787 EUR-PFB.
- Në gjysmën e të gjitha rasteve të ryshfetit (50.1%) pagesa është bërë ose me kërkesë, në mënyrë eksplicite (13.3%) a implicite (30.3%) nga zyrtari publik, ose me kërkesë të palës së tretë (6.5%) në emër të zyrtarit. Ndërsa, në 38% të rasteve, ajo është ofruar nga një përfaqësues i biznesit, pa kërkesë paraprake.
- Rreth një e treta (34%), e të gjitha ryshfeteve të paguara nga bizneset në Kosovë, është paguar para shërbimit, ndërsa 31.7% është paguar pasi shërbimi të jetë kryer.
- Qëllimet kryesore të pagesës së ryshfetit janë për ta përsheptuar një procedurë (28.4%) ose për ta bërë të mundshëm finalizimin e një procedure (13.1%). Përveç kësaj, 23.9% e ryshfetit është paguar duke mos i shërbyer asnjë qëllimi të veçantë.

- Norma e përhapjes së ryshfetit të paguar, zyrtarëve publikë, është më e lartë për zyrtarët e doganave (1.9%) dhe për zyrtarët e taksave/të hyrave (1.8%).
- Vetëm 3.7% e të gjitha ryshfeteve të paguara nga bizneset në Kosovë janë raportuar te autoritetet zyrtare. Pothuajse, një e treta e përfaqësuesve të biznesit (28.2%) nuk e kanë raportuar ryshfetin, sepse ata konsiderojnë se raportimi do të ishte i pakuptimtë, meqë askujt nuk do t'i interesonte për të. Përveç kësaj, 19.2% e të intervistuarve kanë deklaruar se ata nuk e kanë raportuar ryshfetin për shkak të frikës nga hakmarrja.
- Përhapja e ryshfetit, biznes-me-biznes, në Kosovë arrin në 0.6%. Kjo formë e ryshfetit në sektorin privat ka normat më të larta të përhapjes në sektorët e ndërtimtarisë dhe atë të prodhimit industrial të kombinuar (1.2%) dhe në sektorët e tregtisë, akomodimit dhe transportit të kombinuar (0.5%).
- Në më shumë se 90% të rasteve të ryshfetit, biznes-me-biznes, është bërë një kërkesë paraprake nga homologu, ose në mënyrë eksplicite, ose në mënyrë implicite, ose nga një palë e tretë. Qëllimi më i rëndësishëm i ryshfetit biznes-me-biznes në Kosovë është për ta fituar një kontratë (51.4%).
- Bizneset në Kosovë janë të prekura nga forma të ndryshme të krimit, në shkallë të ndryshme: norma e përhapjes 12 mujore e viktimizimit të biznesit është 10.1% për vjedhje me thyerje, 8% për mashtrim nga të jashtmit, 3.2% për vandalizëm, 0.7% për vjedhje të automjeteve motorike (VAM) dhe 0.4% për zhvatje.
- Përqindja e çdo lloji të krimit të raportuar në polici shkon nga 99.1% për VAM, 83% për vjedhje me thyerje, 72% për vandalizëm, 37.6% për rastet e zhvatjes, dhe 19.6% për rastet e mashtrimit nga të jashtmit.
- Katër të pestat e të gjitha bizneseve në Kosovë (80.4%) përdorin, të paktën, një masë mbrojtëse të sigurisë kundër krimit.
- Shumica e përfaqësuesve të biznesit (70.5%) kanë deklaruar se konsiderojnë që rreziku nga krimi për biznesin e tyre, të ketë mbetur stabil, në krahasim me 12 muajt e mëhershëm. Ndërsa, 9.8% mendojnë se ai është në rritje; dhe, 16.2% mendojnë se ai është në rënie.



Hyrje

Në aspekte dhe në një masë të ndryshme, korrupsioni ushtron një ndikim negativ në të gjitha shoqëritë. Siç paraqitet në raportin e UNODC-së së vitit 2011, *Korrupsioni në Kosovë: ryshfeti siç është sprovuar nga popullsia*², edhe pse korrupsioni është i vogël në Kosovë, prapëseprapë mbetet një realitet i përhapur në Kosovë dhe ka një ndikim domethënës në bashkëveprimin e qytetarëve privatë me zyrtarët publikë në vend.

Përveç ndikimit të tyre negativ në ekonomitë familjare private, lloje të caktuara të korrupsionit, gjithashtu mund të kenë pasoja të rënda për sektorin e biznesit dhe ecurinë ekonomike, si dhe mund të bëhen pengesë për investimet private dhe të huaja, për tregtinë dhe për zhvillimin ekonomik. Gjithashtu, mund të preken edhe kompanitë private nga ndikimi i krimit në operacionet e tyre. Kjo mund të variojë prej zhvatjes nga ana e grupeve të organizuara kriminale, të mashtrimet e rënda dhe përvetësimi i fondeve nga ana e menaxherëve, si dhe vandalizmi e sulmet nga konkurrentët kriminalë, ku secila prej tyre ka potencial t'i shkaktojë dëm serioz mjedisit të biznesit, në të cilin veprojnë kompanitë, si dhe ta rrisin koston e të bërit biznes.

Infrastruktura dhe lufta kundër korrupsionit

Ekzistojnë disa institucione dhe njësi në Kosovë që merren me korrupsionin. Në vitin 2003, është themeluar Grupi Punues Ndër-Ministror Kundër Korrupsionit, që përfshin përfaqësues nga të gjitha ministritë qeveritare. Grupi punues në vitin 2004 ka përgatitur Strategjinë e parë Anti-Korrupsion të Kosovës, e cila është plotësuar me Planin e Veprimit Anti-Korrupsion të vitit 2006. Në shkurt të vitit 2012, është themeluar Këshilli Kombëtar Anti-Korrupsion. Dekreti dhe rregullat e procedurës së Këshillit Kombëtar Anti-Korrupsion përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve anëtare. Këshilli ka për qëllim ta përmirësojë koordinimin e institucioneve zbatuese të legjislacionit anti-korrupsion dhe ta rrisë ndërgjegjësimin në mesin e të gjitha organeve të përfshira në luftën kundër korrupsionit.

² UNODC, 2011

Gjatë dekadës së kaluar, Kosova i ka forcuar kapacitetet e saj institucionale për parandalimin dhe hetimin e korrupsionit. Agjencia Kundër Korrupsionit, e krijuar në vitin 2006, fokusohet në implementimin e dy ligjeve të rëndësishme: të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Ligjit mbi Deklarimin e Pasurisë së Zyrtarëve Publikë, si dhe për Strategjinë Anti-Korrupsion dhe Planin e Veprimit. Agjencia, gjithashtu merret edhe me procedimin e ankesave individuale për rastet e korrupsionit të mundshëm dhe ka për obligim t'i njoftojë autoritetet e tjera, të tilla si Policinë dhe Prokurorinë, nëse ajo gjen bazë për hetim të mëtejshëm. Korrupsioni, po ashtu trajtohet edhe nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Zyra e Avokatit të Popullit dhe Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Në aspektin e kapacitetit administrativ, Prokuroria dhe Policia janë riorganizuar me qëllim të përmirësimit të luftës kundër korrupsionit. Në vitin 2010, Prokurori Special themeloi një Grup Punues Anti-Korrupsion, të përbërë nga prokurorë vendorë dhe ndërkombëtarë, hetues policorë dhe ekspertë të anti-korrupsionit, në kuadër të Zyrës së Prokurorisë Speciale. Qëllimi i këtij Grupi Punues është ta hetojë krimin ekonomik dhe financiar, si pastrimi i parave, duke përfshirë rastet e krimit të organizuar. Prokurori i Shtetit, po ashtu e ka emëruar edhe një Koordinator Kombëtar për Anti-Korrupsion në kuadër të Zyrës së Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë. Gjithashtu, Policia ka themeluar një Drejtorin kundër Krimit Ekonomik dhe Korrupsionit. Departamentet e inspektimit janë ngritur në shumë institucione publike, me synim të trajtimit dhe monitorimit të rasteve të korrupsionit dhe sjelljes kriminale.

Shtirja dhe metodologjia e këtij studimi

Përderisa, treguesit e bazuar në perceptim mund të jenë të dobishëm për rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me korrupsionin dhe mobilizimin e mbështetjes për politikën anti-korrupsion, ata dështojnë të ofrojnë indikacione specifike për shkallën e korrupsionit dhe për fushat, veçanërisht, të cënueshme. Për të fituar një vlerësim më real, bazuar në dëshmi të korrupsionit dhe krimit, që prekin sektorin e biznesit, është e nevojshme për të shkuar përtej treguesve bazë, për ta matur perceptimin dhe përvojën aktuale të korrupsionit dhe krimit përmes anketave përfaqësuese të bizneseve.

Gjatë dekadës së kaluar, të kuptuarit e korrupsionit dhe krimit është përmirësuar shumë përmes rezultateve të anketave, të bazuara në mostër të shkallës së gjerë, në kontekste të ndryshme nëpër botë. UNODC ka qenë në pararojë të promovimit të anketave të korrupsionit të ekonomive familjare dhe të anketave të viktimizimit në kontekste të ndryshme dhe ka kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm dhe përsosjen e metodologjive ekzistuese për matjen e korrupsionit dhe krimit. Anketat e fundit të korrupsionit, të mbikëqyrura nga UNODC, në vende të ndryshme, si në: Irak, Afganistan dhe Nigeri, përveç në vendet/rajonet e Ballkanit Perëndimor, ofrojnë njohuri për shkallën dhe natyrën e praktikave korruptive, si dhe një sërë çështjesh të tjera relevante për hartimin e politikave efektive, të tilla si modalitetet konkrete të ryshfetit, si dhe sektorët, pozitat dhe procedurat administrative më të rrezikuara³.

Pas përfundimit të anketave të ekonomive familjare për ryshfet dhe korrupsion në Kosovë dhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, si dhe pas publikimit të rezultateve të anketës në raportet rajonale dhe kombëtare, në vitin 2011, UNODC-ja është kontaktuar dhe i është kërkuar që t'i plotësojë gjetjet nga anketat e ekonomive familjare me një vlerësim të korrupsionit dhe krimit, që prekin sektorin e biznesit në rajon. Më pas,

³ Raportet e anketave për korrupsion të ndërmarra nga UNODC në partneritet me qeveritë kombëtare mund të gjenden në <http://www.unodc.org/unodc/en/data-and-analysis/statistics/corruption.html>.

UNODC-ja ka hyrë në konsultime me homologët kombëtarë dhe donatorët potencialë. Propozim-projekti i rezultuar për kryerjen, në shkallë të gjerë, të Anketës së Bizneseve të bazuara në mostër, që fokusohen në korrupsion dhe krim, është miratuar nga vendet e projektit dhe ka marrë fonde nga Bashkimi Evropian, në kuadër të Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësim 2011⁴.

Për zbatimin e hulumtimit në Kosovë, UNODC-ja krijoi bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK), e cila ka kapacitet të njohur teknik dhe ekspertizë për të kryer anketa, në shkallë të gjerë të sektorit të biznesit. ASK-ja punoi me UNODC-në dhe akterë të tjerë relevantë në Kosovë (duke përfshirë edhe Agjencinë Kundër-Korrupsionit, Odën Ekonomike dhe organizata të ndryshme të biznesit) për ta përpunuar pyetësorin më të përshtatshëm, udhëzimet për intervistuesit dhe mjetet e tjera të anketës. Instrumentet dhe metodologjia e anketës janë rishikuar, testuar dhe rafinuar në takimet me akterët. Një seminar teknik rajonal është organizuar nga UNODC-ja, në qershor të vitit 2012, dhe një anketë testuese në shkallë më të vogël⁵. Në nivel rajonal, një grup këshillues teknik mbikëqyri procesin dhe ofroi kontribut dhe këshilla të ekspertëve.

Pikësynimi kryesor i anketës ishte të prodhohen vlerësime faktike, të bazuara në dëshmi të modeleve dhe natyrës së korrupsionit dhe krimit, që prekin sektorin e biznesit, e të cilat futen në procesin për forcimin e integritetit dhe transparencës, ndërmjet zyrave publike dhe sektorit të biznesit, si dhe për ta promovuar një ambient të përshtatshëm për zhvillimin e biznesit në Kosovë. Hulumtimi u përqendrua në masën, modelet, dhe në llojet më të përhapura, si dhe në modalitetet e korrupsionit, që prekin bizneset, me një fokus të veçantë në ryshfet⁶.

Ky raport kombëtar plotëson analizën e dhënë në raportin rajonal për gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor.⁷ Qëllimi, si në nivel kombëtar ashtu edhe rajonal, nuk është për t'i rreshtuar ose për t'i kategorizuar vendet/rajonet, por për të siguruar njohuri analitike për një fenomen të fshehur. Shpresohet se informatat faktike, të përfshira në këtë raport, do t'i furnizojnë autoritetet publike, si dhe organizatat e biznesit në Kosovës, me një mjet të dobishëm për forcimin e mëtutjeshëm të politikave dhe strategjive të tyre për anti-korrupsion.

⁴ Të gjitha vendet/rajonet e Ballkanit perëndimor e kanë miratuar Programin me Shumë-Përfitues 2011 në bazë të Asistencës gjatë Tranzicionit nga IPA dhe Komponenta e BE-së për Ndërtimin e Institucioneve

⁵ Anketa Testuese (pilot) është zhvilluar në korrik 2012 me 92 biznese në: Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Lipjan dhe Obiliq.

⁶ Ryshfeti është definuar si: (a) premtimi, ofrimi ose dhënia e parave një nëpunësi publik, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, e një avantazhi të padrejtë, për vetë zyrtarin ose një personi a entiteti tjetër, në mënyrë që zyrtari të veprojë ose të mos veprojë në ushtrimin e detyrave të tij ose të saj zyrtare; dhe (b) si kërkim ose pranim nga ana e një zyrtari publik, drejtpërdrejt ose tërthorazi i një avantazhi të padrejtë, për vetë zyrtarin ose një person a entitet tjetër, në mënyrë që zyrtari të veprojë ose të mos veprojë në ushtrimin e detyrave të tij ose të saj zyrtare.

⁷ *Biznesi, Korrupsioni dhe Krimi në Ballkanin Perëndimor*: Ndikimi i ryshfetit dhe i krimit tjetër në ndërmarrjet private, UNODC (2013).



1. Përhapja e ryshfetit

Niveli dhe shpeshësia e ryshfetit

Udhëheqja e një biznesi është, para së gjithash, një veprimtari e sektorit privat, e orientuar drejt klientëve dhe konsumatorëve. Por, aktivitetet komerciale janë të ndëlidhura edhe në rrjetin e shërbimeve publike, të detyrimeve administrative dhe të parakushteve (të tilla si inspektimet tatimore ose zhdoganimet), që kërkojnë bashkëveprime të shpeshta me administratën publike. Disa nga këto (të tilla si paraqitja e deklaratave tatimore) janë të tërthorta, ndërsa të tjerat e marrin formën e bashkëveprimit të drejtpërdrejtë me zyrtarët publikë (të tilla janë inspektimet shëndetësore, të punës, tatimore, procedurat ligjore ose kërkesat për leje të ndërtimit). Lidhur me këtë, kompanitë në Kosovë janë të ngjashme me kompanitë e vendeve të tjera. Më shumë se 9 nga 10 e bizneseve të anketuara (91.2%) kishin të paktën një kontakt të drejtpërdrejtë me një zyrtar publik ose shërbyes civil, në 12 muajt para anketës, me disa variacione, në pesë sektorë të biznesit të anketuar. Norma e bashkëveprimit të drejtpërdrejtë sillej nga 87.7% në sektorin e akomodimit dhe të aktiviteve për shërbime të ushqimit; dhe 93.2% në sektorin e ndërtimitarisë.

Shumica dërrmuese e bashkëveprimeve me zyrtarët publikë ndjekin rregullat dhe rregulloret e aplikueshme në procedurat administrative në fjalë. Por, në çdo bashkëveprim të drejtpërdrejtë, këto rregulla janë të cenuara nga manipulimi, në këmbim të përfitimit privat, si rrjedhojë e një transaksioni të paligjshëm ndërmjet shfrytëzuesit të shërbimit të sektorit privat dhe një shërbyesi civil. Pranimi i parave, i dhuratave ose kundër-favori, përveç tarifës së nevojshme zyrtare, për përfitime personale të një nëpunësi civil, paraqet një akt të ryshfetit administrativ. Siç tregojnë të dhënat, episode të tilla ende luajnë një rol në bashkëveprimet e kompanive private me sektorin publik në Kosovë.


Bashkëveprimi i drejtpërdrejtë ndërmjet një përfaqësuesi të një biznesi dhe një zyrtari publik kërkon që një akt i ryshfetit të ndodhë (duke përfshirë edhe atë përmes një ndërmjetësi). Kështu, përhapja e ryshfetit llogaritet si numri i bizneseve, që i kanë dhënë një zyrtari publik para, dhuratë ose kundër-favor, në të paktën një rast, gjatë 12 muajve para anketës, si përqindje e bizneseve që kishin të paktën një kontakt me një zyrtar publik

në të njëjtën periudhë. Si e tillë, përhapja mesatare e ryshfetit të biznesit në Kosovë është 3.2%, që do të thotë se afërsisht tri në njëqind biznese (3 në 100), në pesë sektorë ekonomikë të anketuar, të cilët kanë pasur kontakt me një zyrtar publik, gjatë 12 muajve përpara anketës, i kanë paguar ryshfet një zyrtari publik.

Por, përhapja e vetë ryshfetit nuk jep një pasqyrë të plotë të masës dhe ashpërsisë së ryshfetit. Një tregues tjetër i rëndësishëm është shpeshësia e pagimit të ryshfetit, e cila në këtë rast do të thotë numri mesatar i herave, që paguesit e ryshfetit, kanë paguar në të vërtetë gjatë 12 muajve para anketës. Në Kosovë, bizneset që paguan ryshfet, kanë paguar mesatarisht 7.7 herë ryshfet për zyrtarët publikë në atë periudhë.

Siç është paraqitur në *Figurën 1*, përderisa përhapja e ryshfetit të biznesit në Kosovë është më e ulët se mesatarja rajonale, shpeshësia e pagimit të ryshfetit në Kosovë është pak më e lartë se në vendet e Ballkanit Perëndimor, si një tërësi (përhapja mesatare prej 10.2% dhe shpeshësia mesatare prej 7.1 në nivel rajonal).

Figura 1 Përhapja e ryshfetit dhe numri mesatar i ryshfetit të paguar, në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor (2012)



Shënim: Përhapja e ryshfetit është llogaritur si numri i bizneseve që i kanë dhënë para, dhuratë ose kundër favor një zyrtari publik, në të paktën një rast në 12 muajt para anketës, si përqindje e bizneseve, të cilat në periudhën e njëjtë kishin të paktën një kontakt me një zyrtar publik. Numri mesatar i ryshfetit i referohet numrit mesatar të ryshfetit të dhënë nga të gjithë ryshfet-paguesit, d.m.th. ata të cilët kanë paguar të paktën një ryshfet gjatë 12 muajve para anketës. Shtyllat tregojnë intervalin e besueshmërisë në 95%.


Përderisa, krahasimet e drejtpërdrejta ndërmjet bizneseve dhe individëve privatë mund të ngrehin çështje të vështira metodologjike, veçanërisht lidhur me madhësinë e kompanive, krahasimi i bizneseve dhe ekonomive familjare private për përhapjen dhe frekuencën e ryshfetit zbulon dallime të rëndësishme në modelin e saj.

Figura 2 tregon përhapjen e ryshfetit dhe normat e shpeshësisë së bizneseve në Kosovë, së bashku me ato të individëve privatë, nga Anketa e Popullsisë së Përgjithshme për Korrupsion dhe Ryshfet, e bërë nga UNODC-ja në vitin 2011⁸. Përhapja mesatare e ryshfetit është shumë më e lartë për individët privatë (11.1%) sesa për bizneset (3.2%). Ndërsa, shpeshësia mesatare e ryshfetit për bizneset (7.7) është më afër me shpeshësinë e individëve privatë (10.2). Kjo tregon se ryshfeti është më i zakonshëm në mesin e

⁸ *Korrupsioni në Kosovë: ryshfeti siç është sprovuar nga popullsia*, UNODC (2011).

qytetarëve privatë (të cilët më shpesh paguajnë ryshfet lidhur me aktivitetet e përditshme) sesa në mesin e bizneseve.

Figura 2 Përhapja e ryshfetit dhe numri mesatar i ryshfetit të paguar, sipas bizneseve dhe sipas qytetarëve privatë, Kosovë (2010-2012)




Shënim: Përhapja e ryshfetit është llogaritur si numri i bizneseve/qytetarëve të moshës madhore (të moshës 18-64), të cilët i kanë dhënë një zyrtari publik para, dhuratë ose kundër-favor, së paku në një rast, gjatë 12 muajve para anketës, si përqindje e bizneseve, qytetarëve të moshës madhore, të cilët në periudhën e njëjtë kishin të paktën një kontakt me një zyrtar publik. Numri mesatar i ryshfetit i referohet numrit mesatar të ryshfetit të dhënë nga të gjithë ryshfet-paguesit d.m.th. ata që kanë paguar të paktën një ryshfet gjatë 12 muajve para anketës. Shtyllat tregojnë intervalin e besueshmërisë në 95%.

Sektorët ekonomikë

Përhapja e ryshfetit tregon variacione thelbësore nëpër sektorët e biznesit në Kosovë. Në mesin e pesë sektorëve të studiuar, prodhimi industrial, furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë, ka normën më të lartë të përhapjes së ryshfetit (4.8%), pasuar nga tregtia me shumicë dhe tregtia me pakicë (3.3%), si dhe akomodimi dhe aktivitetet për shërbime të ushqimit (2.9%). Ndërtimtaria e transporti dhe magazinimi i kombinuar (1.6%) kanë një normë më të ulët të përhapjes së ryshfetit.

Në krahasim me mesataret rajonale, sipas sektorit ekonomik (Figura 3), të gjithë sektorët në Kosovë kanë norma të përhapjes së ryshfetit dukshëm më të ulët: Ndërtimtaria e transporti dhe magazinimi (1.6% kundrejt 11.3%), akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit (2.9% kundrejt 9.0%), si dhe tregtia me shumicë dhe tregtia me pakicë (3.3% kundrejt 10.3%). Kurse, norma të përhapjes së ryshfetit, ndjeshëm më të ulëta, kanë: Prodhimi industrial, furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë (4.8% kundrejt 9.2%). Një normë kjo, që është rreth gjysma e mesatares rajonale.

Figura 3 Përhapja e ryshfetit sipas sektorit ekonomik në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor (2012)




Shënim: Përhapja e ryshfetit është llogaritur si numri i bizneseve që i kanë dhënë një zyrtari publik para, dhuratë ose kundër-favor, së paku në një rast, në 12 muajt para anketës, si përqindje e bizneseve, të cilat në të njëjtën periudhë kishin të paktën një kontakt me një zyrtar publik.

Ndryshimi në përhapjen e ryshfetit sipas sektorit ekonomik ka një ndikim të drejtpërdrejtë në llogaritjen e normës së përhapjes së ryshfetit në nivel kombëtar.

Figura 4 tregon përbërjen themelore të ryshfetit të paguar në pesë sektorë ekonomikë në Kosovë. Sektori i tregtisë me shumicë dhe tregtisë më pakicë përbën pjesën më të madhe (62.3%) të normës totale kombëtare të përhapjes, për shkak të faktit se ky sektor llogaritet se përbën pjesën më të madhe (47.5%) të bizneseve në Kosovë.⁹

Figura 4 Shpërndarja e gjithë ryshfetit të paguar, sipas sektorit ekonomik në Kosovë (2012)




Një tjetër model interesant del në pah, kur shikohet ryshfeti sipas madhësisë së biznesit (numrit të të punësuarve). Përhapja e ryshfetit është më e lartë për bizneset e mesme dhe të mëdha (mbi 50 të punësuar) sesa për bizneset e vogla (10 deri 49 të punësuar) dhe për mikro-bizneset (deri në 9 të punësuar). Siç tregohet në *Figurën 5*, ky është një model i ndryshëm nga ai që gjendet në nivel rajonal. Një shpjegim i mundshëm mund të jetë, se

⁹ Shiko *Figurën 45* për strukturën e ekonomisë.

në Kosovë edhe bizneset shumë të vogla e edhe ato të vogla, në radhë të parë, thjesht nuk mund ta përballojnë ryshfetin.

Figura 5 Përhapja e ryshfetit sipas numrit të të punësuarve, në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor (2012)



Shënim: Përhapja e ryshfetit është llogaritur si numri i bizneseve që i kanë dhënë një zyrtari publik para, dhuratë ose kundër-favor, së paku në një rast, në 12 muajt para anketës, si përqindje e bizneseve, të cilat në të njëjtën periudhë kishin të paktën një kontakt me një zyrtar publik.



2. Natyra e ryshfetit


Format e pagesës

“Me ia mbushë grushtin” me para një zyrtari është një formë e zakonshme e ryshfetit. Por, bizneset gjithashtu mund të ushtrojnë ndikim përmes ofrimit të mallrave ose shërbimeve falas, që ata zakonisht i shesin, ose duke negociuar një shkëmbim të drejtpërdrejtë a të tërthortë me një kundër-favor.

Siç tregohet në *Figurën 6*, nga i gjithë ryshfeti që i është paguar zyrtarëve publikë nga bizneset në Kosovë, 59.2% është paguar me para të gatshme, e që mund të jetë mënyra më e lehtë për fshehjen e veprës. Pothuajse, aq e rëndësishme është edhe ofrimi i ushqimit dhe pijeve, në këmbim të një “favori” të paligjshëm nga ana e zyrtarit publik, që është përgjegjës për më shumë se gjysmën (58.4%) e të gjitha rasteve të ryshfetit në Kosovë.

Në krahasim me format e pagesës së përdorur në nivel rajonal, vlen të përmendet se në Kosovë, një përqindje shumë më e madhe e ryshfetit jepet në formën e pagesave me para të gatshme dhe në formën e ushqimit dhe pijeve. Në nivel rajonal, mbi një e treta e të gjitha ryshfeteve të paguara për zyrtarët publikë nga bizneset (35.7%), është paguar me para të gatshme, pasuar nga ofrimi i mallrave ose avantazheve të tjera (35.6%) dhe në formën e ushqimit dhe pijeve (33.6%).

Figura 6 Përqindja e shpërndarjes së ryshfetit të paguar nga bizneset për zyrtarët publikë, sipas llojit të pagesës, në Kosovë (2012)



Shënim: Të dhënat i referohen ryshfetit të fundit të paguar nga çdo ryshfet-dhënës në 12 muajt para anketës. Shuma është më e lartë se 100%, pasi që, në disa raste, ryshfeti është paguar në më shumë se një formë (për shembull, para dhe mallra).

Në rastin e sektorëve të bizneseve nën studim, pagesa me para të gatshme, në përgjithësi, duket të jetë forma më e përhapur e ryshfetit, përveç në tregti dhe akomodim, ku dhënia e ushqimit dhe pijeve është po aq e rëndësishme.

Ryshfeti i paguar me para të gatshme

Duke pasur parasysh se shumica e ryshfeteve nga bizneset në Kosovë është paguar me para të gatshme, madhësia e ryshfetit të paguar nga ryshfet-dhënësit jep një tregues të rëndësishëm të vlerës së pagesave të saj. Sasia mesatare e paguar për ryshfet, në të gjithë sektorët ekonomikë është 844 euro. Një shifër kjo, që arrin në më shumë se dyfishin e pagës neto mesatare mujore në Kosovë (229%). Në të njëjtën kohë, mediana e ryshfetit të paguar nga ryshfet-dhënësit në Kosovë (500 euro) është ndjeshëm më e ulët se mesatarja, që tregon ndikimin aritmetik të disa ryshfeteve shumë të mëdha (Tabela 1).¹⁰ Duke i marrë parasysh dallimet në nivelet e çmimeve në Evropë, në Kosovë shumica mesatare e ryshfetit në Euro korrespondon me 1,787 EUR-PFB¹¹, ndërsa shumica mesatare e paguar për ryshfet në rajonin e Ballkanit Perëndimor prej 881 EUR-PFB si një e tërë, është ndjeshëm më e ulët.


Kur shikohet madhësia mesatare e ryshfetit të paguar, në para të gatshme, në çdo sektor ekonomik, vlen të përmendet se madhësia mesatare e ryshfetit për prodhimin industrial dhe ndërtimtari të kombinuar (1,183 Euro) është disi më e lartë sesa madhësia mesatare e të gjitha pagesave të ryshfetit (Figura 7). Nga ana tjetër, madhësia mesatare e ryshfetit të paguar në sektorët e tregtisë, akomodimit dhe transportit të kombinuar (740 Euro) është më e vogël sesa mesatarja kombëtare.

¹⁰ Madhësia mesatare e ryshfetit është llogaritur si mesatare aritmetike e ryshfetit të paguar në para të gatshme. Në shumicën e shpërndarjeve, mesatarja është ndikuar nga një numër relativisht i vogël i vlerave shumë të larta. Si një tregues shtesë i shpërndarjes së ryshfetit sipas madhësisë, mund të konsiderohet mediana e madhësisë së ryshfetit. Mediana e madhësisë mesatare të ryshfetit është pikërisht vlera e mesme e të gjitha ryshfeteve të renditura sipas madhësisë së renditur nga më e vogla kah më e madhja, që nënkupton se rreth 50% e të gjitha ryshfeteve janë të larta dhe 50% janë më të ulëta se vlera e medianës.

¹¹ BE-27 Euro Pariteti i Fuqisë Blerëse (EUR-PFB) janë përdorur për t'i bërë shumatat e anketuara në valuta kombëtare të krahasueshme në nivel ndërkombëtar.

Një shpjegim i mundshëm për këtë model mund të gjendet në shpeshtësinë më të madhe të pagesave të ryshfetit në tre sektorët e fundit, duke treguar se ryshfeti (e një vlere më të ulët) është paguar më shpesh në sektorët e tregtisë, akomodimit dhe transportit të kombinuar sesa në sektorin e prodhimit industrial dhe të ndërtimitarisë të kombinuar.

Figura 7 Madhësia mesatare e ryshfetit të paguar nga bizneset për zyrtarët publikë (në euro), sipas sektorit ekonomik, Kosovë (2012)



Një krahasim i madhësisë mesatare të ryshfetit të paguar nga bizneset (844 euro) me shumën korresponduese mesatare, të paguar nga qytetarët privatë (179 Euro), siç gjendet në Anketën e Popullsisë së Përgjithshme, bërë nga UNODC në vitin 2011, për korrupsionin administrativ dhe ryshfetin,¹² tregon se madhësia mesatare e ryshfetit të paguar nga kompanitë është katër herë më e madhe sesa e individëve privatë (Tabela 1). Duke pasur parasysh se bizneset, në mënyrë tipike, kanë një kapacitet shumë më të madh financiar sesa ekonomitë familjare dhe shpesh kanë më shumë për të fituar me anë të ryshfetit, lidhur me transaksionet e tyre të biznesit, kjo nuk është e habitshme.

Tabela 1 Madhësia mesatare e ryshfetit të paguar në para të gatshme nga bizneset dhe nga qytetarët privatë (në euro dhe në EUR-PFB), si përqindje e BPV-së për kokë banori dhe si përqindje e pagës mesatare mujore neto, Kosovë (2010-2012)

Treguesit	Grupi referues	
	Popullsia në Kosovë (2010)	Biznesi në Kosovë (2012)
Ryshfeti mesatar (EUR)	179	844
Mediana e ryshfetit (EUR)	50	500
Ryshfeti mesatar (EUR- PFB)	174	1,787
Ryshfeti mesatar si % e BPV/për kokë banori (2012)	6.5%	30.8%
Ryshfeti mesatar si % e pagës mesatare mujore neto (2011)	48.7%	229.3%

Burimet për treguesit shtesë: EUR-PFB normat e konvertimit dhe BPV për kokë banori: Eurostat; Paga mesatare mujore neto: Agjencia e Statistikave të Kosovës.

¹² *Korrupsioni në Kosovë: ryshfeti siç është përjetuar nga popullsia*, UNODC (2011).


Modaliteti i kërkimit të ryshfetit dhe koha

Të dhënat për modalitetin e ryshfetit mund të ofrojnë një pasqyrë të rëndësishme për mënyrën se si në të vërtetë funksionon dhënia e ryshfetit, zyrtarëve publikë, nga bizneset. Mekanizmat e ryshfeti-dhënies janë karakterizuar shpesh nga modele të caktuara implicite të njohura mirë edhe për ryshfeti-dhëniesit e edhe për ryshfeti-marrësit, që janë të bazuara në të kuptuarit e asaj se kur një pagesë ryshfeti mund të çojë në një avantazh të paligjshëm për të dyja palët.

Kjo është edhe më e vërtetë për bizneset, për të cilat përsheptimi i procedurave administrative ose “prerja e shirit të kuq”, duke anashkaluar ligjet dhe rregulloret me ndihmën e ryshfetit, mund të krijojë përfitime të mëdha. Në fushën ekonomike, ku secili avantazh krahasues mund të çojë në fitime më të mëdha dhe një pjesë më të madhe të tregut për një biznes, kjo mund të rezultojë në një lloj përsheptimi, në të cilën ryshfeti jo vetëm që pritet, por në të vërtetë ofrohet “vullnetarisht” nga bizneset, në mënyrë që t’ua kalojnë konkurrentëve. Kur ryshfeti bëhet një rutinë për kompani të caktuara për të fituar shërbime të privileguara ose përfitime të paligjshme nga zyrtarët publikë. Pagesat mund të priten të jenë më të shpeshta dhe të paguhen më shpesh.

Kur është fjala për modalitetin e ryshfetit në Kosovë, të dhënat tregojnë se bizneset janë shpesh pro-aktive në ndikimin të zyrtarët publikë përmes ryshfetit. Në 38% të të gjitha rasteve të ryshfetit, pagesa e ryshfetit është ofruar nga një përfaqësues i biznesit, pa bërë një kërkesë paraprake. Ndërsa, në rreth gjysmën e rasteve (50.1%), pagesa është kërkuar ose në mënyrë eksplicite (13.3%) ose implicite (30.3%) nga zyrtari publik, ose është kërkuar përmes një pale të tretë (6.5%) në emër të zyrtarit (*Figura 8*).

Figura 8 Shpërndarja në përqindje e ryshfetit të paguar nga bizneset, sipas modalitetit të kërkesave dhe ofertave të ryshfetit, Kosovë (2012)



Shënim: Të dhënat i referohen ryshfetit të fundit të paguar nga çdo pagesë ryshfeti, në 12 muajt para anketës.

Kur krahasojmë modalitetin e ryshfetit nga bizneset me modalitetin e ryshfetit nga qytetarët privatë në anketën me ekonomitë familjare, shfaqen disa ngjashmëri: kur qytetarët privatë u paguajnë ryshfeti zyrtarëve publikë, në 24.7% të rasteve, qytetari e bën ofertën, ndërsa, në 16.9% të rasteve, kërkesa është bërë në mënyrë eksplicite nga zyrtari. Në 20.2% të rasteve, ryshfeti është kërkuar nga qytetari në mënyrë implicite dhe në 11.8% përmes një pale të tretë.


Këto gjetje kanë një numër implikimesh të politikave. Një pjesë e madhe e ryshfetit të kërkuar nga ryshfeti-marrësit tregon se zyrtarët publikë janë mjaft të patrembur për të

kërkuar ryshfet, qoftë nga bizneset qoftë nga ekonomitë familjare. Nëse ryshfet-marrësit nuk presin që të raportohet kërkimi i ryshfetit dhe nuk parashikojnë ndonjë sanksion për nxjerrjen e ryshfetit, ryshfeti mund të shndërrohet në një kulturë të pranueshmërisë dhe të bëhet endemike në zyra të caktuara publike. Në raste të tilla, zyrtarët publikë që marrin ryshfet duhet të jenë në shënjestër të drejtpërdrejtë, duke i dhënë fund mosndëshkimit përmes shpërndarjes dhe zbatimit të rregullave strikte kundër ryshfetit. Nëse ryshfet-dhënësit ndjehen të detyruar të paguajnë ryshfet, ka më shumë gjasa që ata, gjithashtu ta raportojnë ryshfetin. Kjo duhet të inkurajohet nëpërmjet hapjes së kanaleve të mëtejshme për raportimin e rasteve të ryshfetit (të tilla si linjat për raportimin e anti-korrupsionit). Anasjelltas, nëse ryshfet-dhënësit, në mënyrë aktive, iu ofrojnë ryshfet zyrtarëve publikë për të ndikuar në ofrimin e shërbimeve publike në favor të tyre, mund të bëhet thirrje që të vihen reforma ligjore, të cilat e bëjnë të paligjshme “qerasjen” e nëpunësve civilë nëpërmjet “dhuratave” të rregullta.

Përveç identifikimit të palës inicuese në një rast të ryshfetit, gjithashtu është e rëndësishme të dihet për kohën e pagesave të ryshfetit, meqë kjo mund të sigurojë informacion të mëtejshëm për motivimin dhe qëllimin e ryshfetit. Pagesat e bëra paraprakisht janë parë shpesh si një kërkesë për ta kryer punën. Ndërsa, pagesat e bëra pasi shërbimi publik të jetë dhënë mund të shihet ose si një shenjë e mirënjohjes ose si një tjetër formë e “qerasjes”, në të cilën pagesa shërben si një “ëmbëltues” për joshjen e zyrtarëve publikë në një marrëdhënie të varësisë, dhe pranimi i një “dhurate” më herët në kohë, e detyron zyrtarin që t’ia kthejë më vonë favorin biznesit.

Të dhënat tregojnë se 31.7% e të gjitha ryshfeteve nga bizneset në Kosovë janë paguar pasi shërbimi të jetë kryer. Ndërsa, 34% janë paguar ryshfetet para shërbimit, dhe 20.8% janë paguar ryshfetet në të njëjtën kohë. Rreth 9.2% e ryshfetit është paguar pjesërisht para dhe pjesërisht pas shërbimit, ndërsa rreth 4.2% e të anketuarve nuk e mbanin në mend kur ishte paguar ryshfeti (Figura 9).

Figura 9 Përqindja e shpërndarjes së ryshfetit të paguar nga bizneset, sipas kohës së pagesës lidhur me ofrimin e shërbimeve, Kosovë (2012)




Shënim: Të dhënat i referohen ryshfetit të fundit të paguar nga çdo pagues i ryshfetit, në 12 muajt para anketës.

Kur analizohet forma e pagesës së ryshfetit në raport me modalitetin e kërkesave ose ofrimit të ryshfetit, të dhënat tregojnë preferenca të ndryshme të ryshfet-dhënësve dhe ryshfet-marrësve. Zyrtarët publikë, të cilët në mënyrë eksplicite kërkojnë ryshfet, shpesh do ta kërkojnë atë në formën e pagesave me para të gatshme. Ndërsa, bizneset që iu ofrojnë ryshfet zyrtarëve publikë mund të dëshirojnë të shikojnë gjetjen e alternativave,

më pak të kushtueshme, që lidhen me aktivitetet e rregullta të biznesit të tyre, të tilla si: ofrimi i ushqimit dhe pijeve (kur është fjala për sektorin e akomodimit dhe të ushqimit) ose të llojeve të tjera të mallrave dhe shërbimeve (veçanërisht në tregtinë me pakicë dhe shumicë). Të dhënat tregojnë se në shtatë prej dhjetë rasteve të ryshfetit (72.8%), në të cilin është kërkuar ryshfet (qoftë në mënyrë eksplicite, implicite ose nëpërmjet një pale të tretë), pagesa është bërë në para të gatshme, ndërsa ky është rasti vetëm për rreth 38.6% të rasteve, në të cilat biznesi ofron ryshfet në radhë të parë. Në më shumë se katër të pestat të rasteve (80.7%), kur një biznes ofron ryshfet, në krahasim me 45.9% të rasteve, në të cilat është kërkuar ryshfet, pagesa është në formën e ushqimit dhe pijeve (Figura 10).

Figura 10 Shpërndarja në përqindje e ryshfetit të paguar nga bizneset, sipas llojit të pagesës dhe modalitetit të kërkesave dhe ofertave të ryshfetit, Kosovë (2012)



Shënim: Të dhënat i referohen ryshfetit të fundit të paguar nga çdo pagues i ryshfetit, 12 muaj para anketës.

Qëllimi i ryshfetit


Dhënia e ryshfetit zyrtarëve publikë mund të ketë një shumëllojshmëri qëllimesh. Zyrtarët publikë mund të jenë në gjendje të nxjerrin ryshfet për një shërbim publik legjitim, të cilin përndryshe ata mund t'ia mohojnë klientit, ose t'ia vonojnë për një periudhë të pacaktuar. Nga ana tjetër, ryshfeti mund të paguhet edhe me iniciativën e biznesit, me qëllim për të ndikuar ndër të tjera në vendimet rregullative, vlerësimet tatimore, proceset e prokurimeve publike ose sigurimin e shërbimeve publike. Për secilin prej këtyre procedurave, të lidhura me biznesin, qëllimi i ryshfetit mund të ndryshojë sipas natyrës së procesit ose vendimit që është subjekt i manipulimit. Për shembull, ryshfeti mund të synojë të ndryshojë një vendim negativ për një leje ndërtimi dhe në këtë mënyrë lejon finalizimin e një procesi administrativ, në interes të kompanisë.

Në botën ekonomike, ryshfeti po ashtu mund të jetë i rëndësishëm për përshpejtimin e procedurave të shumëllojshme, që rëndom marrin shumë kohë dhe janë të gjata, të tilla si: lidhja në shërbimet publike (energji elektrike ose ujë), zhdoganimi i mallrave, marrja e disa llojeve të caktuara të autorizimit për proceset e prodhimit ose përshpejtimi i inspektimeve të shëndetit dhe sigurisë në lokalet e biznesit, duke i njoftuar paraprakisht për inspektimet e ardhshme. Ndërsa, përshpejtimi i procedurave

administrative, mbi të gjitha mund të mos duket një ide e keqe, përshpejtimi i procedurave ekskluzivisht për bizneset që paguajnë ryshfet, duke iu dhënë prioritet bizneseve të ndershme, krijon konkurrencë të pandershme, duke dëmtonur kështu ekonominë.

Nga ana tjetër, disa ryshfete mund t'i shërbejnë një qëllimi, nga i cili përfitimi i zyrtarit, që e pranon “dhuratën” nuk është i dukshëm menjëherë, si rasti kur një përfaqësues i biznesit përdor “dhurata” si një mënyrë e “qerasjes” së zyrtarit publik, për bashkëveprim në të ardhmen, duke krijuar një marrëdhënie të varur ndërmjet atij zyrtari dhe ryshfet-paguesit.

Figura 11 Shpërndarja në përqindje e ryshfetit të paguar nga bizneset, sipas qëllimit të pagesës, Kosovë (2012)



Shënim: Të dhënat i referohen ryshfetit të fundit të paguar nga çdo pagues i ryshfetit, në 12 muajt para anketës.

Nga perspektiva e bizneseve në Kosovë, qëllimi më i rëndësishëm i pagesës së ryshfetit është për “përshpejtimin e procedurave lidhur me biznesin” (28.4%), që përndryshe do të vonoheshin. Qëllime të tjera, të deklaruara të ryshfetit të paguar, janë “për ta bërë të mundur finalizimin e procedurës” (13.1%) dhe “marrja e një trajtimi më të mirë” (14.7%). Në të njëjtën kohë, pothuajse një e katërta e ryshfetit të paguar (23.9%) nuk i shërben asnjë qëllimi të veçantë të menjëhershëm, të bizneseve që i paguajnë ato, duke sugjeruar se këto janë “ëmbëltues”, që iu jepen zyrtarëve publikë për t’iu “shërbyer” atyre për bashkëveprime në të ardhmen, në interes të kompanisë (Figura 11).




3. Zyrtarët publikë dhe ryshfeti

Ashtu siç ekzistojnë qëllime dhe procedura të caktuara, për të cilat bizneset janë më të prira për të bërë oferta për zyrtarët publikë, ekzistojnë tipe të caktuara të zyrtarëve publikë, që janë të përfshirë në ryshfet më shpesh se të tjerët. Për këtë arsye, është e dobishme që të analizohen gjasat që një tip i caktuar i zyrtarëve të merr ryshfet, kur ai ose ajo të jetë kontaktuar, pavarësisht nga shpeshësia e bashkëveprimit. Për ta matur këtë, numri i bizneseve, që i kanë paguar ryshfet një tipi të përzgjedhur të zyrtarëve publikë është krahasuar me numrin e bizneseve, të cilët kishin kontakte me atë tip të zyrtarëve në 12 muajt para anketës. Me fjalë të tjera, shpërndarja e ryshfetit të zyrtarët e përzgjedhur publikë nga bizneset (*Figura 12*).

Norma e shpërndarjes së ryshfetit të paguar zyrtarëve publikë nga bizneset në Kosovë ndryshon nga 1.9% për zyrtarët e doganave deri në 0.8% për zyrtarët e shërbimeve publike, që do të thotë se gjasat e zyrtarëve doganorë për marrjen e ryshfetit nga bizneset, çdo kohë, që ata janë në kontakt të drejtpërdrejtë me një biznes, është më shumë se dy herë sesa gjasat të zyrtarët e shërbimeve publike. Zyrtarët e taksave/të hyrave dhe zyrtarët komunalë ose provincialë, gjithashtu kanë normë të shpërndarjes mbi 1.3%, ndërsa ato të zyrtarëve të tjerë, të listuar në *Figurën 12*, janë ndërmjet 0.8% dhe 1.2%.

Normat e shpërndarjes së ryshfetit të paguar për shumicën e tipeve të zyrtarëve publikë nga bizneset në Kosovë janë ndjeshëm nën ato të ryshfetit të paguar për tipin e njëjtë të zyrtarëve në rajonin e Ballkanit Perëndimor, si një tërësi, sidomos për zyrtarët e doganave (1.9% kundrejt 6.5%) dhe zyrtarët e policisë (1.2% kundrejt 5.5%). Në të njëjtën kohë, norma e shpërndarjes së ryshfetit për zyrtarët e taksave/të hyrave në Kosovë është më afër me atë të rajonit (1.8% kundrejt 3.4%).

Figura 12 Përhapja e ryshfetit te zyrtarët e përzgjedhur publikë nga bizneset, në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor (2012)




Shënim: Përhapja e ryshfetit është llogaritur si numri i bizneseve, që i kanë dhënë një zyrtari publik para, dhuratë ose kundërfavor, në të paktën një rast, në 12 muajt para anketës, si përqindje e të gjitha bizneseve që në të njëjtën periudhë kanë pasur të paktën një kontakt me një zyrtar publik. Në këtë grafik, përhapja e ryshfetit është llogaritur veçmas për secilin tip të zyrtarëve publikë.

Po ashtu, është e dobishme që të krahasohet norma e përhapjes së ryshfetit nga bizneset te zyrtarët publikë me përhapjen e ryshfetit tek i njëjti tip i zyrtarëve publikë nga qytetarët privatë. Që të dyja, edhe bizneset private e edhe qytetarët e zakonshëm janë të prekur nga ryshfeti, në bashkëveprimet e tyre me zyrtarët publikë, por bizneset dhe qytetarët shpesh merren me sektorë të ndryshëm të administratës dhe kështu mund të ofrojnë perspektiva plotësuese për prekshmërinë e zyrtarëve publikë nga ryshfeti. Për shembull, për qytetarët e zakonshëm në Kosovë, rreziku i të prekurit nga ryshfeti është më i lartë në bashkëveprimet e tyre me zyrtarët e policisë, sesa kur kanë të bëjnë me zyrtarët e doganës ose zyrtarët e tatimit/të hyrave. Nga ana tjetër, rreziqet e ryshfetit për bizneset janë më të mëdha në bashkëveprim me këta të fundit, të cilët mund të paraqesin probleme me procedurat e gjata burokratike (të tilla si zhdoganimi i mallrave përmes doganës), e të cilat, bizneset dëshirojnë t'i kapërcejnë nëpërmjet pagesës së ryshfetit.

Këto modele të ndryshme të rrezikut nga ryshfeti janë paraqitur në *Figurën 13*, e cila krahason përhapjen e ryshfetit te tipet e përzgjedhura të zyrtarëve publikë, që marrin ryshfet nga bizneset me norma ekuivalente në anketën e përgjithshme të popullsisë të UNODC-së së vitit 2011 për korrupsionin dhe ryshfetin në Kosovë¹³

¹³ *Korrupsioni në Kosovë: ryshfet siç është përjetuar nga popullsia*, UNODC (2011).

Figura 13 Përhapja e ryshfetit te tipet e përzgjedhur të zyrtarëve publikë që marrin ryshfet, sipas bizneseve dhe popullsisë, Kosovë (2010-2012)



Shënim: Përhapja e ryshfetit është llogaritur si numri i bizneseve/qytetarëve të moshës madhore, të cilët i kanë dhënë një zyrtari publik para, dhuratë ose kundër-favor, në të paktën një rast, në 12 muajt para anketës, si përqindje e të gjitha bizneseve/qytetarëve të moshës madhore, të cilët në periudhën e njëjtë kanë pasur të paktën një kontakt me një zyrtar publik. Në këtë grafik, përhapja e ryshfetit është llogaritur veçmas për secilin tip të zyrtarëve publikë.



4. Raportimi i ryshfetit

Ekziston një numër arsyesh për bizneset që t'i "fryjnë bilbilit" për ryshfet, duke i raportuar zyrtarët e korruptuar publikë në polici, ose te autoritetet e tjera. Bizneset shpesh ndihen të detyruar që të paguajnë ryshfet, për të marrë shërbime, të cilat normalisht duhet t'u sigurohen nga shteti, pa kosto shtesë, në kohën e duhur dhe me cilësi të pranueshme. Kështu, ryshfeti përbën një shpenzim, që shkurton drejtpërdrejt fitimet e tyre dhe - meqë bizneset ballafaqohen me detyra rutinë, të tilla si: pagesa e taksave, inspeksionet e shëndetit dhe të sigurisë, ose zhdoganimet e rregullta të mallrave përmes doganës - pranimi në heshtje i kërkesës për ryshfet mund t'i rrisë shpresat e zyrtarëve publikë për pagesa të rregullta në të ardhmen, e që me kalimin e kohës, mund të bëhen faktor i rëndësishëm dhe i kushtueshëm. Në të njëjtën kohë, fitimet afatgjata nga tregtia, që një biznes mund t'i fitojë pak nga pak nga pagesa e ryshfetit janë të pasigurta: fakti që një zyrtar publik pranon rregullisht ryshfet është një tregues se ndonjë avantazh ndaj konkurrentëve, i fituar përmes ryshfetit, do të tretet shpejt, nëse edhe bizneset e tjera gjithashtu paguajnë ryshfet.


Në botën reale, megjithatë, nxitje të tilla, të qarta, për ta raportuar ryshfetin te autoritetet, rrallë kthehen në veprim. Në nivel rajonal, mesatarisht vetëm 1.8% e ryshfetit të paguar nga bizneset në Ballkanin Perëndimor është raportuar te autoritetet zyrtare¹⁴. Me rreth 3.7% të të gjitha ryshfeteve të paguara nga bizneset, që është raportuar te autoritetet zyrtare, situata në Kosovë është e ngjashme¹⁵. Gjetjet e anketës në nivel rajonal tregojnë se shumica e raportimeve janë bërë drejtpërdrejt në polici, por disa janë bërë edhe te institucionet e tjera zyrtare, të tilla si: zyrat e Prokurorisë, Agjencia zyrtare Anti-Korrupsion ose linjat e drejtpërdrejta anti-korrupsion. Një numër i vogël i ryshfetit të paguar (0.3% në nivel rajonal) janë raportuar te institucione të tjera jo-zyrtare, të tilla si organizatat joqeveritare ose media.

¹⁴ *Biznesi, Korrupsioni dhe Krimi në Ballkanin Perëndimor: Ndikimi i ryshfetit dhe krimit tjetër në ndërmarrje private*, UNODC (2013).

¹⁵ Për shkak të numrit të ulët të ryshfetit të raportuar te autoritetet kombëtare në Kosovë dhe një diference korresponduese të lartë të gabimit të marrjes së mostrës, rezultatet e hulumtimit për përqindjen e ryshfetit të raportuar tek autoritetet në Kosovë duhet të interpretohen me kujdes.

Duke e pasur parasysh se vetëm një përqindje e vogël e bizneseve i drejtohen autoriteteve zyrtare për të paraqitur ankesë për zyrtarët e korruptuar, që marrin ryshfet, kur në teori, bizneset kanë arsye të mira për denoncimin e ryshfetit, pyetje e rëndësishme që bëhet është pse bizneset nuk e raportojnë ryshfetin? Ngjashëm me vendet e tjera në Ballkanin Perëndimor, arsyeja më e rëndësishme që e kanë përmendur përfaqësuesit e bizneseve që janë përgjigjur në Kosovë, për mosraportimin e ryshfetit, është perceptimi se do të ishte e pakuptimtë të raportohet ryshfeti meqë askujt nuk do t'i interesonte për të (Figura 14). Pothuajse, një e treta e të anketuarve (28.2%), e kanë dhënë këtë arsye për mosraportimin e ryshfetit në Kosovë, krahasuar me mesataren prej 26.3% në Ballkanin Perëndimor. Përveç kësaj, 19.2% e të anketuarve kanë deklaruar se ata nuk e kanë raportuar ryshfetin për shkak të frikës nga hakmarrja. Pjesë kjo, që është më shumë se trefishi i mesatares rajonale (6% në nivel rajonal). Për dallim, pjesa e të anketuarve, të cilët deklaruan se ata nuk janë drejtuar te autoritetet, sepse pagesa ose dhurata është dhënë si shenjë e mirënjohjes për nëpunësit publikë për dhënie e shërbimit të kërkuar (19.4% kundrejt 22.6% në nivel rajonal), ose sepse ata mendojnë se nuk ka nevojë të raportohet ryshfeti meqë është praktikë e zakonshme, që zyrtarët publikë të paguhen ose t'u jepen dhurata (12.4% kundrejt 26% në rajon) ishte nën mesataren rajonale. Një arsye tjetër, e tillë si mungesa e njohurive rreth asaj se ku të raportohet korrupsioni (6.4% kundrejt 1.7% në rajon) është konsideruar si më pak e rëndësishme.

Figura 14 Përqindja e shpërndarjes së bizneseve ryshfet-paguese, që nuk e raportojnë përvojën e tyre te autoritetet/institucionet, sipas arsyeve më të rëndësishme për mosraportim, në Kosovë dhe në rajonin i Ballkanit Perëndimor (2012)



Shënim: Të dhënat i referohen pageseve të ryshfetit, të cilët nuk e kanë raportuar ryshfetin e fundit te autoritetet/institucionet, që e kanë paguar në 12 muajt para anketës.


Gjetjet se pse ryshfeti nuk është raportuar te autoritetet publike në Kosovë përshtaten në modelet e përgjithshme të kohës, modalitetet dhe qëllimet e ryshfetit, të përshkruara në Kapitullin 2. Pjesë e mëdha e ryshfetit në Kosovë është paguar me kërkesën e shërbyesve publikë, para se shërbimi të jetë bërë dhe me para të gatshme. Kjo tregon se shumë biznese ndihen të obliguara t'u paguajnë ryshfet zyrtarëve publikë dhe të mos e raportojnë ryshfetin për shkak të mungesës së besimit në autoritetet ose edhe nga frika e hakmarrjes.

Në të njëjtën kohë, konkluzionet përfundimtare duhet të kualifikohen sipas të dhënave, që lidhen me perceptimin e përfaqësuesve të biznesit lidhur me autoritetet publike në përgjithësi. Në një kontekst më të gjerë, një e katërta e përfaqësuesve të bizneseve në Kosovë (25%) raportuan se ato konsiderojnë se nuk ia vlen që të ankohen tek autoritetet publike (qoftë përmes një agjencie publike ose një institucioni të tillë, si Avokati i

Popullit) kur ndihen se janë trajtuar padrejtësisht (*Figura 15*). Megjithatë, kjo mungesë e besimit në llogaridhënien e institucioneve publike, në përgjithësi është më pak e theksuar në Kosovë sesa në mesataren rajonale (53.5%).¹⁶

Megjithatë, për politikëbërësit e anti-korrupsionit, shifrat sinjalizojnë sfidat për inkurajimin e më shumë bizneseve, që ta raportojnë ryshfetin, dhe në këtë mënyrë, ta lehtësojë luftën kundër korrupsionit. Në fakt, krijimi i kanaleve më të mira dhe më të sigurta të raportimit për denoncimin e veprave të korrupsionit, vetëm do të rezultojë në rritjen e raportimit, kur ekziston një ndjenjë e përgjithshme se të drejtuarit për ndihmë tek autoritetet ia vlen, dhe se, ai pasohet nga veprime konkrete.

Figura 15 Shpërndarja në përqindje e përfaqësuesve të biznesit sipas asaj nëse ata konsiderojnë se ankesat lidhur me administratën publike ia vlejnë, në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor (2012)




Mekanizmat e brendshëm të pajtueshmërisë

Megjithë faktin se shumë pak përfaqësues të bizneseve e konsiderojnë se ia vlen të paraqitet një ankese formale te autoritetet, e edhe më pak, i raportojnë te autoritetet, provat e tyre me ryshfet, shumë biznese kanë pranuar se sjellja e paligjshme si ryshfet dhe mashtrimi mund ta dëmtojë seriozisht reputacionin e tyre dhe interesat e biznesit. Për t'i parandaluar keqpërdorimet e zakonshme, në vendin e punës, dhe për ta rritur integritetin dhe transparencën në bizneset e tyre, kompanitë në mbarë botën, gjithnjë e më shumë, janë duke implementuar politika të brendshme gjithëpërfshirëse të pajtueshmërisë, që specifikojnë disa praktika të papranueshme dhe sanksionimin e shkeljeve të standardeve të përcaktuara.

Në Kosovë, duke qenë larg nga të qenit universal, mekanizma të tillë të brendshëm të pajtueshmërisë janë gjithnjë e më të përhapur. Sipas anketës, rreth katër në dhjetë (41.3%) kompani kanë miratuar një kod të brendshëm etik dhe rreth një e treta (30.8%) kanë miratuar politika dhe udhëzime lidhur me ryshfetin dhe korrupsionin (*Figura 16*). Përveç kësaj, gjashtë në dhjetë, kanë organizuar takime kushtuar kësaj çështjeje, për t'i informuar të punësuarit e tyre për ekzistimin e udhëzimeve dhe politikave anti-korrupsion (60%) dhe një e pesta e kanë shpërndarë këtë informacion me anë të email-it (20.7%).


¹⁶ Mesatarja rajonale nuk i përfshin të dhënat nga Mali i Zi, ku nuk ishte përfshirë kjo pyetje në anketë.

Figura 16 Përqindja e bizneseve që i kanë miratuar masat e brendshme të përzgjedhura të pajtueshmërisë sipas numrit të të punësuarve, Kosovë (2012)



Përderisa përpjekjet e brendshme për ta rritur transparencën dhe integritetin nga sektori privat janë pak a shumë, në mënyrë të barabartë, të zakonshme në të pesë sektorët ekonomikë, të mbuluar nga anketa, të dhënat tregojnë gjithashtu se politika të tilla të pajtueshmërisë janë më pak të zakonshme në mesin e kompanive të vogla sesa në mesin e atyre të mëdha. Siç tregohet në *Figurën 17*, miratimi i kodit të etikës, që u dedikohet politikave dhe udhëzimeve anti-korrupsion, si dhe shpërndarja e tyre nëpërmes takimeve apo email-ve, është më e përhapur në mesin e kompanive më të mëdha sesa në mesin e atyre me më pak të punësuar. Por, duke pasur parasysh, se ndërmarrjet mikro dhe ato të vogla e përbëjnë pjesën më të madhe të të gjitha bizneseve në Kosovë, miratimi i përhapur i standardeve specifike të integritetit dhe politikave të pajtueshmërisë nga bizneset në rajon kërkon promovimin e tyre, jo vetëm në mesin e ndërmarrjeve të mëdha, por edhe në mesin e ndërmarrjeve të vogla dhe shumë të vogla.

Figura 17 Përqindja e bizneseve që e kanë miratuar një kod të brendshëm etik, sipas numrit të të punësuarve, Kosovë (2012)





5. Ryshfeti biznes-me-biznes

Ryshfeti është i lidhur më së shpeshti me zyrtarët publikë, të korruptuar, të cilët pranojnë para, dhurata ose favore të tjera, të paligjshme, që lidhen me ofrimin e shërbimeve publike. Por, sidoqoftë, forma të rëndësishme të ryshfetit ndodhin përbrenda vetë sektorit privat, që do të thotë, ndërmjet përfaqësuesve të entiteteve të biznesit të sektorit privat. Ryshfeti i tillë, në rrjedhën e aktiviteteve ekonomike, financiare ose tregtare është i përcaktuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC) si “premtim, ofrim ose dhënie e ryshfetit (ryshfet aktive), si dhe kërkesë ose pranim i ryshfetit (pasive), drejtpërdrejt, ose në mënyrë të tërthortë, i një avantazhi të padrejtë te/nga çdo person, i cili drejton ose punon, në çfarëdolloj cilësie, për një entitet të sektorit privat... në mënyrë, që ai ose ajo, në kundërshtim me detyrat e tij ose të saj, vepron ose përmbahet nga veprimi”. Konventa kërkon që nënshkruesit e saj të marrin në konsideratë futjen e akteve të tilla si vepra penale.¹⁷

Ryshfeti biznes-me-biznes zhvillohet ndërmjet përfaqësuesve të bizneseve, që japin dhuratë, kundër-favor ose paguajnë para shtesë (duke përjashtuar pagesën normale), për të siguruar një transaksion biznesi. Transaksionet e tilla, të paligjshme, janë të ndryshme nga transaksionet normale të biznesit. Për shembull, aktivitetet e marketingut ose të marrëdhënieve me publikun, synojnë në mënyrë specifike në atë që, me anë të mjeteve të paligjshme, ta shkelin integritetin e ryshfet-marrësis, në këmbim të një ryshfeti. Kjo është një formë e ryshfetit, që pengon mekanizmat e dobishëm të tregut të lirë dhe nuk është i dëmshëm vetëm për bizneset, përfaqësuesit e të cilëve pranojnë ryshfet, por edhe për shoqërinë si tërësi.

Përhapja e ryshfetit biznes-me-biznes është llogaritur si numri i bizneseve, që i kanë dhënë para, dhuratë apo kundër-favor, përveç ndonjë tarife normale të transaksionit, të paktën në një rast gjatë 12 muajve para anketës, ndonjë personi që punon, në çfarëdolloj cilësie, për një entitet biznesi të sektorit privat, duke përfshirë edhe nëpërmjet një ndërmjetësuasi.¹⁸ Siç tregohet në *Figurën 18*, sipas këtij përkufizimi, përhapja mesatare e


¹⁷Neni 21 UNCAC

¹⁸ Meqë të gjitha bizneset, mund të supozohet se, kanë kontakte të rregullta me bizneset e tjera, ose të paktën një kontakt me një biznes tjetër, qoftë si furnizues ose si klient, në 12 muajt e mëparshëm, përhapja llogaritet si përqindje e bizneseve ryshfet-paguese nga të gjitha bizneset.

ryshfeti biznes-me-biznes në Kosovë arrin në 0.6% (kundrejt 4% në nivel rajonal). Megjithëse, më e vogël se përhapja mesatare e ryshfeti, që bizneset i kanë paguar zyrtarëve publikë, ky zbulim tregon se praktika ekziston në Kosovë.

Mundësitë për individët në entitetet e sektorit privat, që të përfshihen në punë të paligjshme me bizneset e tjera të sektorit privat, ndryshojnë nëpër sektorë ekonomikë. Për shembull, përfaqësuesit e bizneseve individuale mund të pranojnë oferta për kontrata, shpenzimet e të cilëve tejkalojnë çmimet aktuale të tregut, në shkëmbim me një pagesë ryshfeti personal; ose punonjësit individualë me qasje në informata konfidenciale, mund ta zbulojnë këtë informacion për bizneset e tjera, në këmbim të një përfitimi personal. Të dhënat tregojnë se episode të tilla të ryshfeti në sektorin privat në Kosovë janë më të zakonshme dhe kanë norma më të larta të përhapjes në sektorët e ndërtimitarisë dhe të prodhimit industrial të kombinuar (1.2%) sesa në sektorët e tregtisë, të akomodimit dhe të transportit të kombinuar (0.5%). Ashtu si në rastin e ryshfeti në sektorin publik, normat e përhapjes së ryshfeti janë më të larta (3.3%) në kompanitë e mesme dhe të mëdha (mbi 50 të punësuar) sesa në kompanitë e vogla (10 deri 49 të punësuar) (2.2%) dhe mikro-kompanitë (deri në 9 të punësuar) (0.5%). Kjo dallon dukshëm me modelet, që gjenden në rajonin e Ballkanit Perëndimor si një tërësi (Figura 18).


Figura 18 Përhapja e ryshfeti në mesin e bizneseve në sektorin privat, sipas sektorit ekonomik dhe sipas numrit të të punësuarve, në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor (2012)



Format e pagesës

Si te ryshfeti në sektorin publik, ashtu edhe në sektorin biznes-me-biznes, pagesa e ryshfeti mund të bëhet në shumë forma: para, mallra, ushqim dhe pije, gjëra me vlerë ose në formën e një shkëmbimi eksplisit për një favor tjetër. Në botën e biznesit në Kosovë, ushqimi dhe pijet, si dhe pagesat në para të gatshme, janë format më të rëndësishme të pagesës së ryshfeti në mesin e entiteteve të sektorit privat, sikurse edhe në ato ndërmjet bizneseve dhe zyrtarëve publikë. Megjithatë, shkëmbimi i një favorit për një favor tjetër, gjithashtu luan një rol të rëndësishëm, kur është fjala për marrëveshje të paligjshme ndërmjet përfaqësuesve të biznesit (Figura 19).

Figura 19 Përqindja e shpërndarjes së ryshfetit, që bizneset ua kanë paguar entiteteve të biznesit në sektorin privat, sipas llojit të pagesës, Kosovë (2012)




Shënim: Të dhënat i referohen ryshfetit të fundit të paguar, nga çdo ryshfet-pagues, në 12 muajt para anketës. Shuma është më e lartë se 100%, pasi që, në disa raste ryshfeti është paguar në më shumë se një formë (për shembull, para dhe mallra).

Modaliteti dhe koha e kërkimit të ryshfetit

Sipas anketës, 6.1% e ryshfetit biznes-me-biznes është paguar pa u kërkuar, nga njëri prej përfaqësuesve të biznesit të përfshirë dhe është ofruar në vend të kësaj nga paguesi i ryshfetit, në mënyrë që të marrë një avantazh të caktuar të paligjshëm (për shembull, për ta lehtësuar, ose për ta përshpejtuar një procedurë, ose për të pasur përparësi mbi një konkurrent). Në të kundërtën, më shumë se 90% e rasteve përfshijnë disa forma të kërkesës. Ryshfeti është dhënë, pasi ajo është kërkuar qoftë në mënyrë eksplicite (25.8%) qoftë në mënyrë implicite (27%). Ndërsa, pothuajse në katër prej dhjetë rasteve (39.2%) kërkimi i ryshfetit ka të bëjë me një palë të tretë.

Është e dukshme, se një pjesë e madhe e ryshfetit është paguar para ofrimit të mallit ose shërbimit në fjalë (53%). Ndërsa, afërsisht një në gjashtë (14.9%) është paguar pas shërbimit. Pjesa tjetër, (30.1%) është paguar ose në të njëjtën kohë ose pjesërisht para dhe pjesërisht pas ofrimit të shërbimit (*Figura 20*).

Figura 20 Përqindja e shpërndarjes së ryshfetit të paguar biznes-me-biznes, sipas kohës së pagesës, që ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve, Kosovë (2012)




Shënim: Të dhënat i referohen ryshfetit të fundit të paguar, nga çdo pagues i ryshfetit, në 12 muaj para anketës.

Qëllimet e ryshfetit

Ryshfeti, të cilën përfaqësuesi i një biznesi i paguan përfaqësuesit të një biznesi tjetër, zakonisht është në dëm të biznesit, përfaqësuesi i të cilit e ka marrë ryshfetin. Ndërsa, biznesi që ka paguar ryshfetin pret të përfitojë nga ryshfeti. Kjo është reflektuar në mënyrë të qartë në faktin se kur është fjala për ryshfetin biznes-me-biznes në Kosovë, qëllimi dukshëm më i rëndësishëm i ryshfetit është që të fitohet një kontratë (51.4%). Rreth një e katërta e ryshfetit është paguar për të fituar një avantazh ekonomik mbi kompanitë konkurrencte, ose për të marrë një informacion të veçantë (25.7%). Përveç kësaj, rreth një e teta e të gjitha ryshfeteve biznes-me-biznes (12.1%) është paguar pa ndonjë qëllim menjëherë të dukshëm, edhe pse mund të supozohet se pagesat e tilla shërbejnë për t'i joshur ryshfet-marrësit në një “varësi” afatgjate, e cila i bën ata më të përshtatshëm për favorizimin e biznesit që paguan ryshfet, në disa pika në të ardhmen (Figura 21).

Figura 21 Përqindja e shpërndarjes së ryshfetit, të paguar biznes-me-biznes, sipas qëllimit të pagesës, Kosovë, (2012)




Shënim: Të dhënat i referohen ryshfetit të fundit, të paguar nga çdo ryshfet-pagues në 12 muajt para anketës.

Raportimi i ryshfetit biznes-me-biznes

Në mesataren rajonale, thjesht vetëm 0.8% e të gjitha ryshfeteve të paguara ndërmjet përfaqësuesve të biznesit, është raportuar te autoritetet, të tilla si: policia, Agjencia Anti-Korrupsion ose te mbikëqyrësit e bizneseve të prekura¹⁹. Rezultatet e përkohshme për Kosovën tregojnë se asnjë nga bizneset, që ishin pjesë e anketës, nuk kishin raportuar ndonjë incident të ryshfetit biznes-me-biznes. Ky është një tregues i faktit se të dyja palët, në një episod të ryshfetit biznes-me-biznes, ndihen njëllë të implikuara në krim dhe nuk janë të gatshëm që të paraqiten dhe t'i "fryjnë bilbilin".

Hamendësimi i mësipërm konfirmohet nga fakti se arsyet më të rëndësishme të të dhënave nga bizneset që paguajnë ryshfet në Kosovë, për mosraportimin e ryshfetit janë: kompania përfiton nga ryshfeti që i paguan një përfaqësuesi të një kompanie tjetër, ose pagesa/dhurata jepet si shenjë mirënjohjeje (23.2%); ryshfet është një praktikë aq e zakonshme saqë nuk ka nevojë të raportohet (22.6%). Pagues të tjerë të ryshfetit nuk i informojnë autoritetet për shkak të frikës nga hakmarrja (13.6%), ose për shkak se ata e konsiderojnë të kotë raportimin e saj, meqë askujt nuk do t'i bëhej vonë për të, ose për shkak të mungesës së njohurive rreth asaj se ku të raportohet (11.3%). Arsyet të ngjashme për mosraportimin e ryshfetit, biznes-me-biznes, janë përmendur në rajonin e Ballkanit Perëndimor si një tërësi (Figura 22)

Figura 22 Përqindja e shpërndarjes së bizneseve, që u paguajnë ryshfet bizneseve të tjera, që nuk e kanë raportuar përvojën e tyre te autoritetet/institucionet, sipas arsyeve më të rëndësishme për mosraportim, Kosovë (2012)



Shënim: Të dhënat i referohen ryshfet-paguesve, të cilët nuk e kanë raportuar ryshfetin e tyre të fundit të paguar tek autoritetet/institucionet, në 12 muajt para anketës.

¹⁹ *Biznesi, Korrupsioni dhe Krimi në Ballkanin Perëndimor: Ndikimi i ryshfetit dhe krimit tjetër në ndërmarrjet private*, UNODC (2013).




6. Perceptimet dhe opinionet lidhur me korrupsionin

Në botën e biznesit, perceptimet janë faktorë themelorë për formësimin e vendimeve, sjelljes ekonomike dhe rezultateve. Përceptimi i një ambienti të favorshëm të biznesit: për shembull, krijon pritjen për një kthim pozitiv nga një investim, duke i bërë bizneset më të prirë që të investojnë, sesa kur ato e perceptojnë një ambient negativ për biznes. Investimi më i madh krijon më shumë kërkesa, më shumë vende pune, rritje më të lartë dhe një ekonomi më dinamike dhe më të begatë. Prandaj, për këtë arsye, në ekonomi perceptimet shpesh shndërrohen drejtpërdrejt në rezultate.

Me qëllim që t'i kryejnë veprimtaritë e tyre ekonomike, në mënyrë efektive, dhe t'i arrijnë qëllimet e tyre të biznesit, kompanitë private kërkojnë një ambient biznesi me kushtet e duhura për t'iu mundësuar atyre, që të jenë edhe produktive edhe fitimprurëse. Këto kushte përfshijnë: sundimin e ligjit për zbatimin e kontratave dhe ofrimin e sigurisë; si dhe mjedisin e duhur rregullator dhe infrastrukturën funksionale. Këto janë vetëm disa për t'u përmendur. Në anën tjetër, mungesa e këtyre kushteve, ose prania e faktorëve të dëmshëm për klimën e biznesit përbëjnë një pengesë për të bërë biznes dhe parandalojnë sektorin privat nga lulëzimi dhe zhvillimi i potencialit të tij të plotë.

Kur janë pyetur, nëse disa çështje të caktuara paraqesin pengesë për të bërë biznes në vendet e tyre, pronarët dhe përfaqësuesit e bizneseve në Kosovë e rendisin korrupsionin si çështjen e parë më të rëndësishme, të pasuar nga taksat e larta dhe mungesa e stabilitetit politik. Në fakt, korrupsioni konsiderohet si një pengesë e madhe nga dy të pestat e përfaqësuesve të biznesit (40.5%), pasuar nga taksat e larta (38.6%) dhe paqëndrueshmëria politike (33.4%). Ndër të tjerë të anketuar, 16.6% e konsiderojnë korrupsionin si një pengesë të moderuar për të bërë biznes. Ndërsa, 32.9% nuk e konsiderojnë atë si pengesë (*Figura 23*).


Figura 23 Shpërndarja në përqindje e përfaqësuesve të bizneseve, që i konsiderojnë çështjet e zgjedhura një pengesë të madhe ose të moderuar për të bërë biznes, Kosovë (2012)



Perceptimi i korrupsionit të zyrtarëve publikë

Kur përfaqësuesit e bizneseve e konsiderojnë korrupsionin të jetë një pengesë për bërjen e biznesit, ata shpesh kanë në mendje tip të veçanta të zyrtarëve publikë (ose procedura specifike administrative) në mesin e të cilëve korrupsioni mund të jetë hasur më shpesh sesa në mesin e të tjerëve. Megjithatë, edhe pse korrupsioni konsiderohet të jetë një pengesë e madhe për të bërë biznes, mbi 80% e përfaqësuesve të bizneseve në Kosovë mendojnë se pagesa e ryshfets, për çdo tip të zyrtarëve publikë, asnjëherë nuk ndodh në kompani të tyre. Në të kundërtën, ndërmjet 1% dhe 3% e bizneseve konsiderojnë se pagesa e ryshfetit për zyrtarët publikë është një praktikë shumë ose mjaft e shpeshtë. (Figura 24).

Figura 24 Përqindja e përfaqësuesve të bizneseve, të cilët konsiderojnë se pagesa e ryshfetit për zyrtarët e përzgjedhur publikë ndodh pak a shumë shpesh në bizneset si të tyrin, Kosovë (2012)




Qëndrimet ndaj sjelljes korruptive

Ashtu si në rastin e perceptimeve të korrupsionit, qëndrimet ndaj asaj që përbën korrupsionin dhe çka është sjellje e pranueshme, shpesh ndryshojnë ndërmjet individëve, shoqërive dhe sektorëve të ndryshëm ekonomikë. Anketimi i përfaqësuesve të biznesit, për qëndrimet e tyre ndaj formave të caktuara të sjelljes korruptive, gjithashtu mund të hedh dritë mbi gatishmërinë e tyre për t'u përfshirë në ryshfet dhe korrupsion, si dhe pritjet e tyre prej saj.

Të dhënat tregojnë se shumica e përfaqësuesve të biznesit janë mirë të vetëdijshëm për kufijt e sjelljes etike në transaksionet e biznesit dhe i klasifikojnë veprimet jashtë këtyre kufijve si “jo të pranueshme”. Megjithatë, ka edhe një numër të konsiderueshëm të tyre, të cilët i kualifikojnë disa veprime të paligjshme si sjellje të pranueshme, veçanërisht kur ashpërsia e shkeljes nuk është menjëherë e dukshme. Për shembull, pothuajse gjysma e përfaqësuesve të bizneseve në Kosovë (44.9%) e konsiderojnë të pranueshëm përdorimin e raporteve dhe kontakteve personale në institucionet publike, për përshpejtimin e procedurave lidhur me biznesin (Figura 25). Gjithashtu, në rastet kur qartazi shkelen standardet etike, ekziston një pjesë e konsiderueshme prej rreth 30% e përfaqësuesve të bizneseve, të cilët i konsiderojnë të pranueshme veprimet seriozisht korruptive (përfshirë përdorimin e burimeve publike për përfitime private ose për interes të një pale të tretë dhe ushtrimin e funksioneve publike, përderisa ka një interes në kompanitë private). Gjithashtu, rreth një e treta e përfaqësuesve të biznesit (30%) e konsiderojnë të pranueshme kryerjen e funksioneve të shumta publike në të njëjtën kohë.


Figura 25 Përqindja e përfaqësuesve të bizneseve, të cilët i konsiderojnë format e ndryshme të sjelljeve korruptive gjithmonë/zakonisht/nganjëherë/të pranueshme, Kosovë (2012)



Qëndrimet e ndryshme ndaj korrupsionit kthehen në modele të dallueshme të ryshfetit. Të dhënat tregojnë se sa më pak që udhëheqësit e bizneseve të jenë të vetëdijshëm se transaksionet e caktuara ekonomike - veçanërisht në bashkëveprime me zyrtarë publikë - janë të papranueshme, më shumë ka të ngjarë, që këta përfaqësues të biznesit të jenë të angazhuar në sjellje të tilla. Madje, edhe për një formë relativisht “të butë” të ndërhyrjes së paligjshme me zyrtarët publikë (përdorimi i marrëdhënieve dhe kontakteve personale në institucionet publike, për përshpejtimin e procedurave lidhur me biznesin) mund të

tregohet se sa më shumë përfaqësues të bizneseve i konsiderojnë të pranueshme këto veprime të paligjshme, aq më e lartë është përhapja e rryshfetit (*Figura 26*).


Figura 26 Përhapja e rryshfetit, sipas grupeve të përfaqësuesve të bizneseve, të cilët e konsiderojnë përdorimin e marrëdhënieve në institucionet publike gjithmonë/zakonisht/nganjëherë/jo të pranueshme, Kosovë (2012)



Perceptimi i shkaqeve të korrupsionit

Anketimi i përfaqësuesve të biznesit për perceptimin e tyre mbi shkaqet e korrupsionit mund të hedhë dritë mbi disa shkaqe të korrupsionit, që mund të synojnë në mënyrë të dobishme një strategji efektive anti-korrupsion. Të dhënat tregojnë se më shumë se gjysma (55.8%) e përfaqësuesve të bizneseve i konsiderojnë pagat e ulëta të zyrtarëve publikë si shkak të përbashkët të korrupsionit. Përveç kësaj, më shumë se dy të pestat (44.5%) e përfaqësuesve të bizneseve në Kosovë i konsiderojnë fuqitë e mëdha të zyrtarëve publikë të jenë shkak i zakonshëm i korrupsionit (*Figura 27*). Shkaqe të tjera të perceptuara të korrupsionit janë një ndikim i tepruar i individëve të fuqishëm (43.6%), mungesa e integritetit të zyrtarëve (39.1%) dhe mungesa e mekanizmave të përgjegjshmërisë (38.2%).

Figura 27 Përqindja e përfaqësuesve të bizneseve, të cilët konsiderojnë se çështje të ndryshme të jenë një shkak i zakonshëm i korrupsionit/shkak i pjesshëm i korrupsionit/jo shkak i korrupsionit, Kosovë, (2012)




Ndikimi i ryshfetit në investimet e biznesit

Përveç që ka një efekt të drejtpërdrejtë në prirjen e bizneseve për të paguar ryshfet, perceptimi i ryshfetit ka një efekt të tërthortë mbi gatishmërinë e bizneseve për të bërë investime të mëdha, e cila ka pasoja potencialisht katastrofike për rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Gjithsej, 3.3% e bizneseve në Kosovë vendosën të mos bëjnë investime të mëdha në 12 muajt para anketës, për shkak të frikës se duhet të paguajnë ryshfet për t'i marrë shërbimet e kërkuara ose lejet.

Duke pasur parasysh se, në radhë të parë, vetëm një pjesë e caktuar e bizneseve janë në gjendje për të bërë investime të mëdha, fakti se korrupsioni ka një ndikim të tillë negativ është i rëndësishëm. Por, ndoshta aspekti më i dëmshëm për zhvillimin ekonomik në rajon është se ndikimi ekonomik i ryshfetit në klimën e biznesit dhe vendimet për investime është më i theksuar për bizneset më të vogla, sesa për bizneset e mëdha (Figura 28). Kompanitë mikro (3.3%) dhe ato të vogla (3.4%) janë shumë më të prekura se kompanitë e mesme dhe të mëdha (1.9%), që do të thotë, se frika nga ryshfeti ka një ndikim më të madh, pikërisht në ato biznese me potencial më të madh për rritje.

Figura 28 Përqindja e përfaqësuesve të bizneseve, të cilët vendosën të mos bëjnë investim të madh, në 12 muajt para anketës, për shkak të frikës nga ryshfeti, sipas numrit të të punësuarve, Kosovë (2012)





7. Përhapja dhe modelet e formave të tjera të krimit

Përveç korrupsionit, bizneset në Ballkanin Perëndimor, sikur se bizneset kudo tjetër, janë të prekura nga format e tjera të ndryshme të krimit kundër pasurisë së tyre ose kundër aktiviteteve të biznesit. Ndikimi i krimeve të tilla mund të jetë i konsiderueshëm, në aspektin e shpenzimeve dhe dëmeve të drejtpërdrejta të shpenzimeve indirekte, në formën e primeve të sigurimit, të shpenzimeve të sigurisë dhe mundësive të humbjes së investimeve. Duke e pasur parasysh se krimi është renditur si një nga katër pengesat më të rëndësishme për të bërë biznes në Kosovë (Figura 23), vlen të përmendet se një pjesë shumë e konsiderueshme e bizneseve e konsiderojnë krimin të jetë pengesë e madhe (28%), ose pengesë e moderuar (12.3%) për të bërë biznes.

Matja e ndikimit të drejtpërdrejtë të krimit është sfiduese për një numër arsyesh, pavarësisht nëse viktimat janë individë a biznese. Krimet e raportuara në polici janë kuptuar gjerësisht si nën-numërim i shkallës së vërtetë të aktivitetit kriminal. Para se një krim të regjistrohet në statistikat e krimit administrativ, ai patjetër duhet të zbulohet, të raportohet në polici, të njihet si një vepër kriminale dhe të regjistrohet si një krim në statistikat e policisë. Një numër i madh i krimeve nuk janë raportuar në polici dhe disa prej atyre që janë raportuar nuk janë regjistruar në statistikat policore. Kufizime të tilla në statistikat zyrtare të krimit mund të kapërcehen me ndihmën e anketave të viktimizimit nga krimi, të cilat japin të dhëna për vlerësimin e të ashtuquajturave “shifrat e errëta” të krimit, që nuk janë raportuar në polici. Të dhënat e tilla ofrojnë njohuri të vlefshme shtesë për natyrën dhe modalitetet e veprës penale, si dhe karakteristikat e viktimave - informacion ky, i cili nuk është zakonisht në dispozicion nga të dhënat zyrtare të policisë.

Bizneset në Kosovë janë të prekura nga forma të ndryshme të krimit, në shkallë të ndryshme, varësisht prej madhësisë së tyre, llojit të aktivitetit ekonomik, vendndodhjes dhe faktorëve të tjerë. Në mesin e pesë llojeve të rëndësishme të krimit,²⁰ norma 12-mujore e përhapjes së viktimizimit të biznesit në Kosovë është më e larta për vjedhje (10.1%), ku një në dhjetë biznese është viktimizuar gjatë 12 muajve të fundit.


²⁰ Shih Shtojcën Metodologjike për përkrahje të hollësishme të këtyre krimeve.

Për më tepër, shumë kompani që janë sprovuar me vjedhje me thyerje janë viktimizuar më shumë se një herë - bizneset e tilla bien viktimë e vjedhjes me thyerje mesatarisht 1.8 herë në vit. Shkalla e përhapjes për mashtrim nga të jashtmit është gjithashtu e konsiderueshme (kjo përfshin mashtrimin nga konsumatorët, distributorët ose furnizuesit, por përjashton mashtrimin nga të punësuarit dhe menaxherët). Rreth 8% e bizneseve në vit janë mashtruar përmes mënyrave të ndryshme, si nga konsumatorët që mashtrojnë kompaninë, në lidhje me gatishmërinë e tyre për të paguar, mashtrimin të furnizuesit në lidhje me cilësinë a sasinë e mallrave, ose shërbimeve të ofruara, ose nëpërmjet mashtrimit kompjuterik (Figura 29). Për më tepër, bizneset e viktimizuara bien viktimë e mashtrimit 5.3 herë në vit.

Në rastin e akteve të vandalizmit kundër bizneseve, ku ndërtesat, pajisjet ose prona të tjera në lokalet e biznesit janë dëmtuar qëllimisht nga aktet e përdorimit të forcës, zjarrvënies, grafitëve ose mjeteve të tjera, 3.2% e të gjitha bizneseve janë viktimizuar në një mesatare prej 1.3 herë në 12 muajt e mëparshëm. Norma e përhapjes së vjedhjes së automjeteve motorike (VAM) është më pak se 1% (0.7%), me viktima që vuajnë një mesatare prej 1.2 të incidenteve (shumë biznese të prekura kanë më shumë se një automjet të kompanisë në përdorim në një kohë, duke përfshirë automobilat, furgonat, kamionët, autobusët dhe automjetet e tjera motorike).

Të dhënat tregojnë, gjithashtu se 0.4% e të gjitha bizneseve kanë rënë viktimë e zhvatjes në 12 muajt para anketës (meqë zhvatja shpesh është një aktivitet i vazhdueshëm, nuk është llogaritur asnjë frekuencë mesatare).

Figura 29 Normat vjetore të përhapjes për lloje të ndryshme të krimit kundër bizneseve dhe numri mesatar i krimeve për biznes të viktimizuar në vit, Kosovë (2012)



Shënim: Normat vjetore të përhapjes për mashtrim nga të jashtmit, vjedhje me thyerje dhe vandalizëm janë llogaritur përkatësisht si numri i kompanive që janë sprovuar me secilën prej këtyre krimeve, si përqindje e numrit të përgjithshëm të kompanive; norma vjetore e përhapjes së vjedhjes së mjeteve motorike është llogaritur si numri i kompanive që kanë përjetuar të paktën një vjedhje të një makine, furgoni, kamioni, autobusi ose ndonjë automjeti motorik tjetër në 12 muajt para anketës, si përqindje e kompanive, që kanë në pronësi makinë, furgon, kamion, autobus ose ndonjë mjet tjetër motorik. Numri mesatar i krimeve është llogaritur si numri mesatar i herëve, që bizneset e viktimizuara nga një krim e kanë sprovuar atë lloj të krimit.

Ndërsa, duke marrë parasysh faktin se krahasimi i rezultateve të anketës, me ato në vende të tjera, mund të ndikohet nga divergjencat në procedurat e anketës, të tilla si: ndryshimet në përzgjedhjen e mostrës, formën e anketës, normat e përgjigjes dhe procedurat e peshimit/ponderimit, një krahasim ndërkombëtar me gjetjet e anketës në vendet e tjera do të shtojë një perspektivë të mëtejshme mbi rezultatet e fituara. Krahasimi është më i madh

me rezultatet e anketës së fundit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ku është përdorur dizajni i njëjtë dhe metodologji e njëjtë e anketës²¹. Përveç kësaj, rezultatet e një pilot ankete në mbarë BE-në për viktimizimin e biznesit pritet të publikohen në fund të 2013²².

Kostoja e krimit

Të dhënat e anketës tregojnë se kostoja mesatare e dëmit kriminal, të shkaktuar nga pesë llojet e krimit, që janë mbuluar, është e konsiderueshme në Kosovë. Megjithatë, kostot e tilla janë të shpërndara në mënyrë shumë të pabarabartë, me një numër të kufizuar të incidenteve të krimit, që shkaktojnë dëme jashtëzakonisht të kushtueshme dhe një numër të madh të incidenteve, që rezultojnë në kosto të dëmit nën-mesatar. Kjo shpërndarje asimetrike mund të përshkruhet duke përdorur dy tregues të veçantë, përkatësisht koston (mesatare) të dëmit kriminal dhe medianën e koston së dëmit kriminal²³. Siç tregohet në *Tabelën 2*, kostoja mesatare e dëmit kriminal është rreth 2 deri 3 herë më e lartë sesa kostoja mesatare e të gjitha llojeve të krimit, me përjashtim të vandalizmit, për të cilin kostoja mesatare është shumë e lartë dhe raporti ndërmjet mesatares dhe medianës është 7.6.

Tabela 2 Kostoja e dëmit ekonomik, të shkaktuar nga incidenti i krimit të fundit të sprovuar nga bizneset në Kosovë (në Euro dhe Euro-PFB), sipas llojit të krimit, Kosovë (2012)

Kostoja e dëmeve kriminale	Vjedhja me thyerje	Vandalizmi	Vjedhja e automjeteve motorike	Mashtrimi nga të jashtmit
Dëmi mesatar (EUR)	2,420	4,974	7,802	7,876
Mediana e dëmit (EUR)	900	650	5,000	2,700
Mesatarja e dëmit (EUR-PFB)	5,089	9,492	16,519	16,161

Viktimizimi i shumëfishtë nga krimi

Të kuptuarit e karakteristikave të bizneseve, që janë sprovuar shumë herë me një lloj të caktuar të krimit, gjatë një periudhe të shkurtër, është shumë i rëndësishëm për përcaktimin e përqendrimit të rrezikut nga krimi, për lloje të caktuara të bizneseve, ose të bizneseve në lokacione të caktuara²⁴. Për ta shqyrtuar akumulimin e lartë të rrezikut, sipas bizneseve të caktuara, është e dobishme që bizneset e viktimizuara të ndahen në grupe sipas numrit të herave, që një lloj i caktuar i krimit, është sprovuar në 12 muajt pararendës. Siç tregohet në *Figurën 30*, mashtrimi nga të jashtmit është një krim që ka tendencë, për shënjestër, të njëjtin biznes shumë herë: me mbi 20% të bizneseve të viktimizuara më shumë se një herë; dy herë 18.7%; tri herë 15.5%; dhe 42.6% katër ose më shumë herë. Nga ana tjetër, rreth 57% e bizneseve të viktimizuar janë sprovuar me një

²¹ *Biznesi, Korrupsioni dhe Krimi në Ballkanin Perëndimor: Ndikimi i rryshfetit dhe krimit tjetër në ndërmarrjet private*, UNODC (2013)


²² Gallup/Transcrime (e ardhshme), Anketa e BE-së për ta vlerësuar nivelin dhe ndikimin e krimeve kundër biznesit, Faza 2: Testimi i modulit të anketës. Raporti Final.

²³ Mediana e koston së dëmit kriminal është pikërisht vlera mesatare e të gjitha dëmeve, të renditura në mënyrë progresive, që nënkupton se rreth 50% e të gjitha dëmeve të shkaktuara janë më të larta dhe 50% janë më të ulëta se vlera mesatare.

²⁴ Kjo nganjëherë quhet edhe "norma e viktimizimit shumë herë nga krimi" dhe tregon përqindjen e bizneseve të viktimizuar, që janë sprovuar me një lloj të caktuar të krimit, më shumë se një herë, gjatë vitit të kaluar nga të gjitha bizneset, që janë sprovuar me krimin gjatë vitit të kaluar.

vjedhje, 21.2% me dy vjedhje, 12.1% me tri vjedhje dhe 9.4% me katër ose më shumë incidente të tilla. Një model i ngjashëm vlen për vandalizmin: 82.2% e bizneseve të viktimizuara janë sprovuar me një incident të tillë; 10.1% me dy incidente; 6.7% me tri dhe 0.8% mekatër ose më shumë incidente të tilla.

Figura 30 Përqindja e shpërndarjes së bizneseve të viktimizuara, që janë sprovuar me një lloj të caktuar të krimit, në një ose disa raste, në 12 muajt e mëparshëm, Kosovë (2012).




Shënim: Shpërndarja sipas numrit të krimeve është llogaritur si përqindje e shpërndarjes së numrit të herave, që bizneset janë viktimizuar nga një lloj i caktuar i krimit, që janë sprovuar me këtë lloj krimi.

Viktimizimi sipas sektorit ekonomik

Një analizë e përhapjes së viktimizimit të biznesit në pesë sektorët ekonomikë, të mbuluar nga anketa, tregon disa dallime të theksuara ndërmjet normave të viktimizimit nga krimi në sektor specifik në Kosovë. Siç tregohet në *Figurën 31*, normat e përhapjes në sektor specifik për vandalizëm, në përgjithësi, janë nën 4.5% në të gjithë sektorët. Normat e përhapjes së vjedhjes me thyerje janë në ose nën 9% në të gjithë sektorët, me përjashtim të shërbimeve të tregtisë me shumicë dhe tregtisë me pakicë, ku ato arrijnë në 11.6%. Në të njëjtën kohë, bizneset në sektorin e transportit dhe magazinimit (2.6%) janë viktimat të mashtrimit nga të jashtmit, më rrallë se bizneset në prodhim industrial, furnizim me energji elektrike, gaz dhe ujë (9.7%), në tregtinë me shumicë dhe tregtinë me pakicë (9.2%), në akomodim dhe aktivitete të shërbimit të ushqimit (5.6%) dhe në sektorin e ndërtimitarisë (5.2%)²⁵.

²⁵Të dhënat për sektor specifik për zhvajtje dhe vjedhje të automjeteve motorike nuk janë në dispozicion, meqë numri në mostër i bizneseve të viktimizuara, që janë sprovuar me ato krime, në secilin sektor është shumë i vogël për të lejuar krahasime statistikisht të rëndësishme.

Figura 31 Normat vjetore të përhapjes për vjedhje me thyerje, vandalizëm dhe mashtrim nga të jashtmit, të sprovuar nga bizneset, Kosovë (2012)




Shënim: Normat vjetore të përhapjes për mashtrim nga të jashtmit, vjedhje me thyerje dhe vandalizëm janë llogaritur përkatësisht si numri i kompanive, që janë sprovuar me secilin prej këtyre krimeve, si përqindje e numrit të përgjithshëm të kompanive.

Vjedhja me thyerje

Vjedhja me thyerje është akt i thyerjes në mënyrë të paligjshme dhe hyrjes në objekte (të biznesit) me qëllim për të vjedhur diçka, pa ardhur në kontakt me ndokënd në ato lokale. Si e tillë, jo të gjitha përpjekjet për vjedhje me thyerje janë të suksesshme në kuptimin që autorët e krimit ia dalin të vjedhin diçka të vlefshme. Nga të gjitha incidentet e vjedhjes me thyerje, të raportuara nga bizneset kosovare në anketë, 5% mund të klasifikohen thjeshtë si përpjekje për vjedhje me thyerje, meqë asgjë nuk ishte vjedhur në të vërtetë.

Në rastet kur diçka me të vërtetë është vjedhur nga lokalet e një biznesi, zakonisht ekziston një shumëllojshmëri e gjërave me vlerë për t'u marrë. Siç tregohet në *Figurën 32*, në më shumë se dy të pestat (42%) janë marrë mallra të tjera (jo të prodhuara nga vetë kompania), dhe në më shumë se një të katërtën e rasteve (27.8%) janë marrë para, që i përkasin biznesit të viktimizuar. Gjësente të tjera, të vjedhura, zakonisht janë makineria ose pajisjet (25.1%) dhe mallra të prodhuara nga vetë kompania (15.9%).

Figura 32 Përqindja e shpërndarjes së gjërave me vlerë, të vjedhura nga bizneset, në rastet e vjedhjes me thyerje, Kosovë (2012)



Shënim: Të dhënat i referohen vjedhje së fundit me thyerje që ka rezultuar me vjedhjen e ndonjë lloji të gjërave me vlerë, në tri vitet para anketës. Shuma është më e lartë se 100%, pasi që në disa raste, më shumë se një lloj i gjërave me vlerë është vjedhur (për shembull, makineri dhe të holla).

Qëllimi i vjedhjes me thyerje, gjithashtu varet nga lloji i biznesit, në të cilin është hyrë për të vjedhur dhe lloji i makinerisë, pajisjes dhe gjësëndeve të tjera, të vlefshme në përdorim. Për shembull, makineria dhe pajisjet janë llojet më tipike të gjërave me vlerë që janë vjedhur nga bizneset e ndërtimtarisë (58.7%). Ndërsa, paraja që i përkiste kompanisë është lloji i gjësëndeve me vlerë, që është vjedhur më së shpeshti në sektorin e akomodimit dhe aktiviteteve për shërbim të ushqimit (35%). Kurse, mallrat e tjera të mbajtura në magazinë, por jo të prodhuara nga kompania në fjalë janë artikujt që iu janë vjedhur më së shpeshti bizneseve në sektorin e tregtisë me pakicë dhe tregtisë me shumicë (48.5%).

Vandalizmi


Aktet e vandalizmit kundër bizneseve mund të jenë shumë të dëmshme në aspektin e dëmit të drejtpërdrejtë dhe shpenzimeve për riparim, humbjes së produktit final të prodhimit, si dhe të përkeqësimit të imazhit të lokaleve afariste dhe zvogëlimin e atraktivitetit të tyre për klientë. Mesatarisht, aktet e vandalizmit në Kosovë, më së shpeshti i kanë në shënjestër ndërtesat (64.2%), makineritë dhe pajisjet (21.9%) dhe automjetet që i përkasin biznesit në shënjestër (16%).

Vjedhja e automjeteve motorike (VAM)

Vjedhja e automjeteve motorike është e ndryshme nga llojet e tjera të krimit kundër bizneseve, që janë raportuar këtu, sepse lokacioni fizik i veprës penale mund të jetë në ambientet e biznesit ose diku tjetër. Në fakt, të dhënat për lokacionin e VAM-it të bizneseve në Kosovë tregojnë se shumica e tyre ndodhin larg ambienteve të biznesit. Ndërsa, një e pesta e incidenteve të tilla (21.9%) ndodhin drejtpërdrejt nga lokalet afariste (të tilla si parkingu ose garazhet); pak më shumë se gjysma e VAM-it (53.6%) ndodh jashtë lokaleve afariste, por brenda të njëjtës komunë ku ato lokale gjenden; si dhe rreth

një e katërta e VAM-it ndodh gjetiu, si në vend ashtu edhe jashtë vendit (24.6%) (Figura 33). Në rastin e këtij të fundit, për shembull gjatë udhëtimeve afariste.

Figura 33 Shpërndarja e lokacionit të vjedhjeve të automjeteve motorike të bizneseve, Kosovë (2012)



Shënim: Të dhënat i referohen vjedhjes së fundit të automjetit motorik, në tri vitet para anketës. Automjetet motorike përfshijnë automobilat, furgonat, kamionët, autobusët ose automjetet e tjera.

Një pjesë e caktuar e automjeteve të vjedhura, më vonë mund të rikthehen. Në shumë raste, kundërvajtësit e përdorin automjetin e vjedhur vetëm për një kohë të kufizuar (për shembull, për të ashtuquajturën “xhiro me makinë”, ose për transport, ndërsa bëjnë një tjetër krim) dhe e braktisin automjetin pas një kohe në një vendin, ku ai mund të gjendet dhe t’i kthehet pronarit. Sipas të dhënave, çdo i katërti automjet motorik (24.5%), që i është vjedhur një biznesi në Kosovë, në fund është rikthyer pasi është vjedhur.

Zhvatja

Përderisa, përhapja e zhvatjes për bizneset në Kosovë është nën 1% (0.4%), megjithatë ajo është arsye për brengosje. Zhvatja është një krim shumë serioz, në të cilin autorët e krimit përpiqen të marrin para ose përfitime të tjera nga një kompani, duke i kërcënuar ose duke i frikësuar menaxherët ose të punësuarit.

Në disa raste, zhvatja është paraqitur edhe si ofertë për “mbrojtje” nga dëmtimet e pronës ose personave dhe paratë e paguara paraqiten si një lloj i “parave për mbrojtje”. Në disa raste, zhvatja mund të jetë e lidhur me grupet e krimit të organizuar, të cilët kanë fuqi dhe mjete për të bërë kërcënim të besueshëm ndaj një biznesi me pasoja potencialisht të tmerrshme, nëse kërkesat e tyre nuk plotësohen.

Të dhënat tregojnë se kërcënimet për zhvatje marrin një shumëllojshmëri të formave të kërcënimit. Sipas bizneseve të viktimizuara në Kosovë, pothuajse gjysma (47.1%) e kërcënimeve për zhvatje përfshijnë kërcënime specifike personale, për ta dëmtuar pronarin, menaxherin, të punësuarit ose të afërmit e tyre. Përderisa, pothuajse gati të gjithë ata (45.4%) përmendin dëmet specifike të biznesit ose pronës së tyre. Rastet e tjera përfshijnë pasoja negative të paspecifikuara dhe kërcënime të tjera, të tilla si: dëmtim i klientëve, kontaminim i produkteve ose rrëmbim i të punësuarve, i menaxherëve ose edhe i të afërmeve të tyre.

Është e dukshme se metodat e përdorura për t’i përcjellë kërcënimet për zhvatje të bizneseve në Kosovë janë mjaft tradicionale dhe duket se janë të projektuara për të pasur


ndikimin më të madh të mundshëm në personat e kërcënuar. Në më shumë se një të tretën e rasteve (36.5%) një ose disa kundërvajtës kanë hyrë në ambientet e biznesit të viktimizuar, për ta përcjellë kërcënimin. Ndërsa, pothuajse në po aq shumë raste (31.7%), kërcënimet është bërë gjetiu në takim personal. Në rreth një të katërtën (25.5%) e rasteve kërcënimet për zhatje janë komunikuar thjesht me anë të telefonit. Në rastet e zhatjes, goftë brenda ose jashtë lokaleve afariste, ku janë përdorur armë, kërcënimet është bërë kryesisht me armë (42.5%), thikë (4.7%) ose gjësende të tjera (57.5%) të përdorur si armë.

Raportimi i krimit në polici

Bizneset që kanë qenë viktime të krimeve kanë një numër arsyesh për ta raportuar incidentin në polici dhe për t'u dhënë informacion të hollësishëm autoriteteve lidhur me rrethanat dhe dëmin e shkaktuar. Në mesin e këtyre arsyeve janë shpresa për rikthimin e pasurisë së vjedhur dhe parandalimin e dukurive të ngjashme në të ardhmen. Gatishmëria për t'i raportuar krimet në polici ndryshon me nivelin e përgjithshëm të besimit ndaj policisë. Por, gjithashtu varet edhe nga lloji i krimit dhe pritja se çfarë mund dhe do të bëjë policia lidhur me veprën penale të raportuar.

Faktorë të tjerë, që kanë ndikim në raportimin e krimit janë: serioziteti i krimit dhe shuma e dëmit të pësuar; humbja e mundshme e reputacionit në mesin e klientëve dhe të konsumatorëve; si dhe kërkesat formale për pagesat e sigurimeve. Siç tregohet në *Figurën 34*, pjesa e secilit lloji të krimit, të raportuar në të vërtetë në polici, sillet nga 99.1% për VAM dhe 83% për vjedhje me thyerje, deri në 72% për incidente të vandalizmit; 37.6% për rastet e zhatjes; dhe 19.6% për rastet e mashtrimit nga të jashtmit. Mesatarisht, për pesë llojet e krimit, që janë mbuluar bizneset e viktimizuar në Kosovë, kanë raportuar gjysmën e krimeve, me të cilat janë sprovuar në tri vitet para anketimit (53.9%). Për krahasim, ryshfeti i zyrtarëve publikë është raportuar te autoritetet në vetëm 3.7% të rasteve, siç tregohet në Kapitullin 4.

Figura 34 Normat e raportimit në polici nga bizneset sipas llojit të krimit, Kosovë (2012)




Shënim: Normat e raportimit për ryshfet i referohen sprovimit të fundit me ryshfet në 12 muajt para anketës, të raportuar te autoritetet zyrtare. Për format e tjera të krimit, normat e raportimit i referohen krimit të fundit të sprovuar në tri vitet e fundit dhe të raportuar në polici.

Në shumë raste, arsyet kryesore që bizneset i raportojnë krimet në polici janë për t'i rikthyer pronat dhe besimin e përgjithshëm, se krimet duhet të raportohen në polici:

ndërmjet 65.2% dhe 88% e bizneseve, që i kanë raportuar incidentet e vjedhjes me thyerje dhe të vandalizmit, i kanë përmendur këto arsye, si dy motivet kryesore të tyre. Arsye të tjera, të rëndësishme për raportimin e krimit, janë dëshira që autorët e krimit të kapen (vjedhje me thyerje: 46.8%; vandalizëm: 78.1%; VAM: 40%) dhe për ta ndaluar krimin që të mos ndodhë përsëri (vjedhje me thyerje: 39.2%; vandalizëm: 42.8%; vjedhje e automjeteve motorike: 27.2%). Pretendimi i pagesave të sigurimit nuk është motiv dominues për raportimin e krimit në Kosovë, as për VAM (37.2%). Kjo tregohet në *Figurën 35*, e cila tregon një nivel të ulët të mbulimit të sigurimit kundër krimit sipas bizneseve.


Figura 35 Arsyet për raportimin në polici të vjedhjes së automjeteve motorike (VAM) nga bizneset, Kosovë (2012)



Shënim: Të dhënat i referohen rastit të fundit të vjedhjes së automjeteve motorike (VAM) të sprovuar në tri vitet para anketës dhe të raportuara në polici. Shuma është më e lartë se 100%, ngase në disa raste, ekziston më shumë se një motiv për raportimin e vjedhjes së automjeteve motorike në polici (për shembull, për t'i rikthyer pronat dhe për arsye të sigurimit).

Informacioni lidhur me kënaqshmërinë e viktimave të krimit me autoritetet për zbatimin e ligjit mund të jetë i dobishëm për përmirësimin e shërbimeve dhe procedurave të policisë. Në rastin e bizneseve, që bien viktimë e krimit, një pjesë e madhe e atyre që e kanë raportuar incidentin në polici ishin tërësisht ose kryesisht të kënaqur me mënyrën se si policia ishte marrë me raportimet e tyre. Ashtu si në rastin e raportimit në polici, kënaqshmëria me punën e policisë sillet sipas llojit të krimit të raportuar dhe është më e ulët për vjedhjen e automjeteve motorike (18.3% ishin të kënaqur); dhe më e lartë për vjedhje me thyerje, ku 44.5% e bizneseve, që kanë raportuar ishin të kënaqur. Nga ana tjetër, rreth një e treta e bizneseve nuk ishin të kënaqur me veprimin e ndërmarrë pas raportimit të krimit në polici. (*Figura 36*).


Figura 36 Kënaqshmëria e bizneseve me policinë, sipas llojit të krimit të raportuar në polici, Kosovë (2012)



Shënim: Të dhënat i referohen incidentit të krimit të fundit të sprovuar në tri vitet para anketës dhe të raportuar në polici.

Arsyet kryesore, të vrojtuar, për pakënaqshmëri me mënyrën që policia reagon ndaj raportimit të krimit, shpesh janë të lidhura me vështirësitë e zgjidhjes së krimit në fjalë dhe marrjes së kompensimit për biznesin e viktimizuar. Në rastin e vandalizmit, për shembull, viktimat e pakënaqura ishin të pakënaqura ose jo plotësisht të kënaqura kryesisht për shkak të faktit se policia nuk i ka gjetur autorët e krimit (98.7%) ose për shkak të perceptimit se policia nuk po bën mjaft (61.3%). Ka pasur pak biznese, që mendonin se nuk ishin trajtuar në mënyrë korrekte (36.9%) ose nuk marrin mbrojtje të mjaftueshme nga krimi (16.1%), siç tregohet në *Figurën 37*.

Figura 37 Arsyet për pakënaqshmërinë e bizneseve, që kanë raportuar vandalizmin në polici, Kosovë (2012)




Shënim: Të dhënat i referohen rastit të fundit të vandalizmit të sprovuar në tri vitet para anketës dhe të raportuar në polici. Shuma është më e lartë se 100%, meqë në disa raste, ekziston më shumë se një arsye për pakënaqshmëri me policinë (për shembull, policia nuk i ka gjetur autorët e krimit dhe nuk na ka trajtuar si duhet).

Në rastin e krimeve kundër biznesit, që janë raportuar më rrallë, të tilla si vandalizmi dhe mashtrimi, ekziston një numër arsyesh pse krimi nuk është raportuar në polici. Këto arsye varen nga lloji i krimit. Për shembull, në rastet e vandalizmit rreth gjysma (50.2%) e

bizneseve kanë konsideruar se nuk ia vlen të raportohet krimi në polici. Ndërkohë për mashtrim, numri i incidenteve të raportuara është 37.4% (Figura 38). Në rastin e mashtrimit, pothuajse një e katërta e të anketuarve (24.1%) nuk e raportojnë atë në polici, për shkak se konsiderojnë se policia nuk mund të bëjë asgjë. Arsye të tjera, të ndryshme, për mosraportimin e krimit, ishin veçanërisht të rëndësishme për rastet e mashtrimit nga të jashtmit (41.5%).

Figura 38 Arsyet për mosraportimin e llojeve të përzgjedhura të incidenteve të krimit në polici, Kosovë (2012)




Shënim: Të dhënat i referohen incidentit të fundit të krimit të sprovuar në tri vitet para anketës, që nuk ishte raportuar në polici. Shuma është më e lartë se 100%, meqë në disa raste, ekzistojnë më shumë se një arsye për të mos e raportuar incidentin në polici (për shembull, policia nuk mund të bëjë asgjë, si dhe frika nga hakmarrja).

Masat për parandalimin e krimit dhe kostoja

Siç tregojnë të dhënat nga kjo anketë, bizneset në Kosovë përballen me një rrezik real nga krimi dhe dëmet, si dhe shpenzimet e tij përcjellëse. Për ta mbrojtur veten nga krimi, bizneset shpesh instalojnë sisteme të posaçme të sigurisë (sisteme alarmi, kamera) ose përdorin rojet e sigurisë ose masa të tjera. Në total, katër të pestat e të gjitha bizneseve në Kosovë (80.4%), përdorin të paktën një masë mbrojtëse të sigurisë ndaj krimit. Siç tregohet në *Figurën 39*, masat e sigurisë të përdorura gjerësisht janë: patrullat e sigurisë gjatë kohës jashtë orarit të punës (53.3%), sistemet e alarmit (36.8%) dhe kamerat (27.3%). Ndërkaq, masat mbrojtëse të sigurisë, më pak të përdorura gjerësisht janë: rrethojat mbrojtëse ose pengesat (16.5%), rojet e sigurisë (16.1%), patrullat e sigurisë gjatë orëve të punës (15.8%), dyert speciale për mbrojtje (8.2%) dhe dritaret speciale mbrojtëse (7.4%).


Figura 39 Përqindja e bizneseve që përdorin masa të përzgjedhura të sigurisë kundër krimit, Kosovë (2012)



Shënim: Të dhënat i referohen të gjitha bizneseve në Kosovë. Shuma është më e lartë se 100%, pasi që në disa raste, është përdorur më shumë se një masë e sigurisë (për shembull, sistemi i alarmit dhe kamera).

Krimi kundër bizneseve shpesh shkakton dëm të konsiderueshëm për bizneset. Për ta mbrojtur veten kundër implikimeve financiare, bizneset mund t'i shfrytëzojnë polisat e sigurimit, të cilat paguajnë kompensim për dëmet. Në Kosovë, vetëm një pakicë e bizneseve kanë ndonjë lloj të sigurimit kundër pasojave të krimit. Mesatarisht, vetëm 15.7% e të gjitha bizneseve kanë një lloj të veçantë të polisës së sigurimit, që në mënyrë specifike, mbrojnë kundër ngjarjeve të krimit. Ndërsa, 17.8% kanë një polisë të përgjithshme të sigurimit, që gjithashtu mbrojnë kundër incidenteve kriminale, dhe 65.2% nuk kanë sigurim kundër krimit (Figura 40).

Figura 40 Përqindja e bizneseve që kanë një polisë sigurimi kundër krimit, sipas llojit të sigurimit, Kosovë (2012)




Perceptimet dhe mendimet lidhur me krimin

Sikur te perceptimet për korrupsionin, përveç përvojës objektive, perceptimet lidhur me rrezikun nga krimi, janë të ndikuara nga një numër faktorësh. Raportet e mediave dhe ndjenja e përgjithshme e pasigurisë dhe e frikës mund të kontribuojnë për ta ngritur perceptimin e rrezikut nga krimi, siç bën pamja fizike e një zone. Perceptimet e tilla,

gjithashtu mund të ndikojnë në shkallën, në të cilën krimi në një fushë të caktuar është perceptuar të jetë në rritje ose në ulje.

Shumica e përfaqësuesve të biznesit në anketë (70.5%) kanë deklaruar se konsiderojnë që rreziku nga krimi për biznesin e tyre ka mbetur stabil në krahasim me 12 muajt e mëparshëm. Ndërsa, 9.8% e të anketuarve kanë parë një rritje të rrezikut nga krimi; dhe 16.2% kanë parë rënie; kurse, 3.5% nuk kanë shprehur asnjë mendim. Këto perceptime të udhëheqësve të biznesit tregojnë një ndjeshmëri në rënie ndaj krimit (*Figura 41*).

Figura 41 Perceptimet, nëse rreziku nga krimi për entitetin e biznesit të dikujt, është rritur, ka mbetur stabil ose është ulur, Kosovë (2012)




Ndikimi i krimit në investimet në biznes

Megjithëse, perceptimet vetëm të rrezikut nga krimi, nuk kanë një lidhje të madhe reciproke me rrezikun e vërtetë nga krimi, siç matet prej përvojës së krimit nga bizneset, perceptimet e tilla megjithatë kanë rëndësi për formimin e opinioneve në lidhje me “klimën mbizotëruese të biznesit” dhe vlerësimin e biznesit dhe mundësive për investim. Një perceptim negativ i situatës së përgjithshme të krimit në një vend mund të çojë në pakësimin e investimeve dhe ndikimin në zhvillimin dhe rritjen ekonomike.

Të dhënat tregojnë se frika nga krimi është me të vërtetë një faktor shumë i rëndësishëm në vendimin e udhëheqësve të biznesit, për të bërë një investim të madh. Përderisa, ka dallime në ndikimin e këtij faktori, sipas sektorit ekonomik (*Figura 42*), mesatarisht 9.1% e të gjithë liderëve të biznesit kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të mëparshëm, ata kanë vendosur që të mos bëjnë një investim të madh, për shkak të frikës nga krimi. Kjo është një pjesë shumë e rëndësishme e të gjitha bizneseve, duke e pasur parasysh, në radhë të parë, se vetëm një numër i kufizuar i bizneseve janë në gjendje për të bërë investime të mëdha. Duhet ta rikujtojmë se, përveç bizneseve, që kanë vendosur të mos bëjnë investime prej frikës nga krimi, mbi 3% e bizneseve, e kanë anuluar vendimin për investim, nga frika e korrupsionit (Kapitulli 6). Së bashku, frika nga krimi dhe korrupsioni, i shtojnë një pengesë të konsiderueshme zhvillimit ekonomik në Kosovë.

Figura 42 Përqindja e përfaqësuesve të bizneseve, të cilët kanë vendosur për të mos bërë një investim të madh, në 12 muajt para anketës, për shkak të frikës nga krimi, sipas sektorëve, Kosovë (2012)





8. Vërejtjet përfundimtare

Ndonëse, mund të jetë e vështirë të përcaktohet sasia e korrupsionit, ky raport tregon se anketat për të sprovuarit e drejtpërdrejtë me korrupsionin, mund të ndihmojnë për të nxjerrë, të paktën, një pamje të pjesshme se, si, pse, kur, ku dhe sa ndikon korrupsioni në sektorin e biznesit në Kosovë. Nga kjo analizë, elementet e mëposhtme mund të ruhen për shqyrtim të mëtejshëm, në funksion të zhvillimit të masave efektive anti-korrupsion në nivel kombëtar:

- Anketa identifikon disa sektorë të biznesit, të cilët janë me prioritet, të tilla si: ndërtimtaria dhe akomodimi me aktivitetet për shërbim të ushqimit, si dhe llojet e caktuar të zyrtarëve publikë, duke përfshirë zyrtarët e doganave, zyrtarët e taksave/të hyrave dhe zyrtarët komunalë ose provincialë, në të cilët vëmendja duhet të përqendrohet në një përpjekje për ta penguar përfshirjen në ryshfet.
- Normat e përhapjes së krimit “jakë-bardhë”, të tillë si: ryshfeti dhe mashtrimi, janë disi më të larta, por normat e raportimit të ryshfetit dhe të mashtrimit janë shumë më poshtë se ato të krimeve të tjera tradicionale. Ky dështim, për ta raportuar korrupsionin, nënkupton se ekziston një mungesë e besimit në autoritete dhe se organizatat e biznesit duhet të jenë më proaktive në inkurajimin dhe promovimin e masave anti-korrupsion, në kodet e etikës dhe në integritetin.
- Çështja e ryshfetit, biznes-me-biznes, e theksuar në këtë raport, hedh dritë të re mbi praktikën e paligjshme të “marketingut”, në formën e ryshfetit të përdorur për të fituar një avantazh të padrejtë ndaj bizneseve rivale. Analiza e mëtejshme, e praktikave të tilla, duhet të ndërmerret për ta ndihmuar garantimin e një “fushë-loje të barabartë”, në vendin e tregut dhe të garantojnë, se mekanizma zakonisht të dobishëm të tregut të lirë, të mbeten të pacenuar nga korrupsioni. Një përmbledhje e dispozitave ligjore kundër korrupsionit në Kodin Penal të Kosovës duhet të sigurojë, që, përveç dispozitave kundër ryshfetit të zyrtarëve publikë, të jenë në dispozicion edhe instrumentet efektive ligjore kundër ryshfetit në sektorin privat.
- Frika se duhet paguar ryshfet, për t’i marrë shërbimet e kërkuara ose lejet, i çon në total prej 3.3%, të të gjithë udhëheqësve të bizneseve në Kosovë, që të mos

bëjnë një investim të madh, në 12 muajt para anketës. Kjo tregon “efektin e përhapjes”, që korrupsioni mund ta ketë, me pasoja potencialisht katastrofike për rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Sidomos, kur vetëm një pjesë e caktuar e bizneseve në radhë të parë janë në gjendje për të bërë investime të mëdha. Çdo përpjekje e bërë, për ta frenuar korrupsionin, duhet të reklamohet gjerësisht për ta parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të investimeve dhe të zhvillimit ekonomik.

- Ndonëse, krimet tradicionale ndaj bizneseve sjellin kosto të konsiderueshme për ekonominë, bizneset në Kosovë duket se mendojnë relativisht pak për parandalimin e krimit, në formën e masave të sigurisë dhe zbutjen e pasojave të krimit, me anë të polisave dedikuar sigurimit.
- Megjithëse, në dukje i vogël në aspektin numerik, fakti se 0.4% e të gjitha bizneseve në Kosovë bien viktimë e zhvatjes, ende është domethënëse, për shkak se zhvatja është një krim që mund të jetë i lidhur me grupet e organizuara kriminale. Kjo arsye, e vetme, nënkupton se marrëdhënia ndërmjet zhvatjes dhe biznesit duhet të hulumtohet tërësisht.
- Përveç pasojave të drejtpërdrejta të krimit, që thjesht janë duke u hetuar, korrupsioni dhe mashtrimi mund të kenë pasoja negative për reputacionin e kompanisë. Shumë kompani, në mbarë botën, janë duke e pranuar këtë dhe shumë e më shumë janë duke zbatuar politika të brendshme gjithëpërfshirëse të pajtueshmërisë, që specifikojnë disa praktika të palejueshme dhe sanksionojnë shkeljet e standardeve të përcaktuara. Në Kosovë, këta mekanizma të brendshëm të pajtueshmërisë janë ende larg universale dhe kanë nevojë për promovim të mëtejshëm. Në veçanti, politikat e pajtueshmërisë janë më pak të zakonshme në mesin e kompanive më të vogla. Duke e pasur parasysh, se mikro- kompanitë dhe kompanitë e vogla, përbëjnë pjesën më të madhe të të gjitha bizneseve në Kosovë, kjo situatë duhet të trajtohet.
- Ndërgjegjësimi për korrupsion dhe se çfarë konsiderohet sjellje e papranueshme në Kosovë është i lartë; dhe, më shumë se gjysma e përfaqësuesve të bizneseve e konsiderojnë korrupsionin pengesë për të bërë biznes, ryshfeti shpesh duket se tolerohet si një mjet për t'u bërë gjërat, ose për të marrë trajtim më të mirë. Një vlerësim i mëtejshëm i ndërgjegjësimit për korrupsionin, në mesin e udhëheqësve të biznesit, mund të merret në konsideratë dhe mund të zhvillohen iniciativa të mëtejshme, për ta rritur të kuptuarit lidhur me efektet e dëmshme të korrupsionit në ndarjen efikase të resurseve në ekonominë e tregut.
- Meqë, të dhënat kanë të bëjnë me perceptimin e nivelit të korrupsionin, opinioni publik lidhur me korrupsionin në Kosovë tregon një nivel të konsiderueshëm të shqetësimit. Një mundësi është, për aq sa ka gjasa të jetë e mundshme, zbatimi i mëtejshëm i politikave anti-korrupsion që organizatat e biznesit dhe pjesëtarët e tyre përbërës do t'i mirëpresin.

Anketa aktuale përfaqëson përpjekjen e parë për ta kryer një vlerësim gjithëpërfshirës të përvojës aktuale të biznesit me ryshfetin në Kosovë, në mënyrë që të ndihmojë në identifikimin e masave efektive për ta luftuar atë. Vlera e shtuar mund të fitohet në qoftë se dukuria përsëritet me kalimin e kohës, në mënyrë që të monitorohen ndryshimet në përvojën dhe ndikimin e ryshfetit në Kosovë.

Një sistem i tillë monitorimi për korrupsionin, në nivel kombëtar, duhet të përfshijë një shumëllojshmëri të mjeteve për të mbledhur prova lidhur me manifestimet e tij, të ndryshme, dhe të ndihmojë në politikëbërje:

- Vlerësimet sektoriale të kushteve të punës dhe të integritetit të nëpunësve civilë sipas sektorëve (sektori i shëndetësisë, gjyqësisë, policisë, doganave, etj.) me qëllim të sigurimit të më shumë informacioneve më të hollësishme e specifike dhe ndihmës në identifikimin e masave në shënjestër të politikave. Kjo duhet të jetë prioritet në fushat, veçanërisht të cenueshme nga ryshfeti, siç tregohet në këtë anketë dhe Anketën e Përgjithshme të Popullsisë të UNODC-së së vitit 2011.
- Vlerësimet e përgjithshme të përvojës me ryshfetin dhe format e tjera të korrupsionit (si për popullsinë e përgjithshme ashtu edhe për sektorin e biznesit), me qëllim të ofrimit të standardeve dhe matjes së progresit.
- Një sistem për monitorimin e reagimit shtetëror ndaj korrupsionit, si me masa ndëshkuese ashtu edhe me masa parandaluese, me qëllim të identifikimit të praktikave të suksesshme dhe të pasuksesshme.


Një sistem kombëtar i monitorimit të korrupsionit mund të iniciohet dhe të zhvillohet nga organet kryesore anti-korrupsion të vendit. Sistemi duhet të gëzojë vëmendjen dhe besimin e publikut dhe të organizatave relevante të shoqërisë civile. Përfshirja e mëtejshme e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), e ministrive përkatëse dhe e qendrave kërkimore me përvojë, me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare dhe rajonale, do të mundësojë që mekanizmi monitorues të prodhojë informacion relevant dhe të cilësisë së lartë për luftimin e korrupsionit, në një mënyrë më efektive.



Shtojca I: Konteksti ekonomik i korrupsionit të biznesit në Kosovë

Historia ekonomike e Kosovës, e kohëve të fundit, është e lidhur ngushtë me rënien progresive ekonomike të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ). Me kohë, Jugosllavia u shpërbë viteve të '90-ta, ekonomitë e shteteve pasardhëse ranë në mënyrë dramatike, pati një kolaps në prodhim dhe punësim, pati mungesa të përhapura dhe hiper-inflacion. Rimëkëmbja ekonomike u kthye në Kosovë vetëm pas vitit 2001, e ndjekur nga rritja solide ekonomike deri në efektet e krizës globale financiare dhe ekonomike nga viti 2007, që e kanë ngadalësuar rritjen ekonomike. Edhe pse tendencat e rritjes së BPV-së në Kosovë janë të ngjashme me mesataren (e peshuar) në Ballkanin Perëndimor, ekonomia ka realizuar vazhdimisht mbi trendin e rritjes rajonale, gjatë pesë viteve të kaluara (*Figura 43*). Investimet publike e kanë zbutur ndikimin e krizës ekonomike në rritjen ekonomike, me një pjesëmarrje të investimeve publike, që u rritën prej 5% të BPV-së në vitin 2007 dhe në 11% në vitin 2011.


Figura 43 Ndryshimi në përqindje i BPV-së, në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor (2007-2012)



Burimet: Eurostat; Raporti i Progresit i BE-së 2012; Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (WIIW) 2013

Papunësia për një kohë të gjatë është një nga problemet fundamentale në Kosovë (Figura 44). Sipas rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore të vitit 2009, papunësia është theksuar veçanërisht te femrat (56.4%) dhe te të rinjtë (73%)²⁶. Përderisa, shkalla e punësimit, historikisht është e ulët në Kosovë, papunësia në anën tjetër ka qenë e lartë. Megjithatë, sipas rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore për vitin 2012 (AFP, nuk është realizuar AFP-ja për vitet 2010 dhe 2011) shkalla e papunësisë te fuqia punëtore ka rënë në 30.9%, pas asaj të vitit 2009, që ishte 45.4%.

Figura 44 Normat e punësimit dhe e papunësisë në Kosovë (2007-2012)



Burimi: Eurostat

Në aspektin e strukturës ekonomike, shumica e kompanive në Kosovë operojnë në vetëm pesë sektorë të ekonomisë. Duke ndjekur "Klasifikimin Statistikor të Aktiviteteve Ekonomike në Komunitetin Evropian" (NACE), këta pesë sektorë janë definuar si:

1. Prodhim industrial, furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë ²⁷
2. Ndërtimtari²⁸
3. Riparimi i automjeteve motorike dhe motoçikletave ²⁹
4. Transporti dhe Magazinimi³⁰
5. Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit (hotelet dhe restorantet) ³¹

Në Anketën aktuale për Korrupsionin dhe Krimin që prekin bizneset janë anketuar vetëm bizneset nga këta pesë sektorë, duke përjashtuar aktivitetet e tjera ekonomike (të tilla si arsimit, bujqësia ose shërbimet shëndetësore). Kjo përzgjedhje e sektorëve ekonomikë, po ashtu siguron një përfaqësim të gjerë të ekonomisë kosovare lidhur më vlerën e shtuar (përqindje e BPV-së sipas sektorëve) dhe punësimin (përqindja e totalit të të punësuarve në çdo sektor), si dhe pjesën e bizneseve të mbuluara. Pesë sektorët e listuar, llogaritet të përbëjnë 79.7% të të gjitha bizneseve në vend, 76.4% të totalit të të punësuarve dhe 42%

²⁶ Rezultatet e AFP 2009

²⁷ Kategoritë C,D, E të NACE Rev.2.

²⁸ Kategoria F e NACE Rev.2.

²⁹ Kategoria G e NACE Rev.2.


³⁰ Kategoria H e NACE Rev.2.

³¹ Kategoria I e NACE Rev.2.

të BPV-së së përgjithshme (netos së taksave). Pjesa tjetër është shpërndarë në mesin e të gjitha aktiviteteve të tjera ekonomike, që në mënyrë tipike kryhen si nga bizneset private (si bujqësi, miniera, aktivitete financiare, aktivitete të pasurive të patundshme, profesionale, veprimtari shkencore a teknike) ose nga institucionet publike (administratë publike, mbrojtje, arsim, shëndetësi).

Shikuar më afër strukturën e bizneseve në Kosovë (Figura 45), pjesa më e mëdha e tyre janë në sektorin e tregtisë me shumicë dhe tregtisë me pakicë; dhe në riparim të automjeteve motorike dhe motoçikleta (47.5%), kurse sektori i prodhimit industrial, furnizim me energji elektrike, gaz dhe ujë (11%) dhe sektori i akomodimit dhe aktiviteteve për shërbim të ushqimit (8.3%). Aksionet e bizneseve të vogla janë në ndërtimtari (6.1%) dhe ato të transportit dhe magazinimit (6.8%).

Figura 45 Shpërndarja relative e bizneseve në pesë sektorët ekonomikë, të përfaqësuar në anketë, në Kosovë (2012)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Një tjetër karakteristikë e rëndësishme strukturore është se shumica e bizneseve në Kosovë janë krahasimisht të vogla në aspektin e numrit të të punësuarve: 96.6% e të gjitha bizneseve të regjistruara, në pesë sektorët e mbuluar, kanë më pak se 10 të punësuar; 2.7% kanë ndërmjet 10 dhe 49 të punësuar; 0.6% e të gjitha bizneseve kanë ndërmjet 50 dhe 249 të punësuar, ndërsa vetëm 0.1% e të gjitha bizneseve kanë më shumë se 250 të punësuar³². Me gjithë dominimin e njësive shumë të vogla të biznesit, duhet theksuar se rëndësia relative e kompanive më të mëdha është shumë më e madhe në aspektin e kontributit të tyre në BPV dhe punësimin e përgjithshëm sesa që paraqet përqindja e tyre në numrin e bizneseve.

³² Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)



Shtojca II: Metodologjia

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë mbledhur në një anketë kombëtare, të kryer si pjesë e projektit të financuar nga BE: “Vlerësimi i Korrupsionit dhe Krimin që prekin Sektorin e Biznesit në Ballkanin Perëndimor”. Projekti përfshiu shtatë anketa të administruara, në mënyrë të pavarur, të cilat janë kryer në mënyrë autonome nga partnerët kombëtarë, në përputhje me mjetet e anketës, të zhvilluara bashkërisht dhe me standardet e përbashkëta metodologjike.

Një pyetësor bazë është zhvilluar bashkërisht dhe pas testimit në një anketë testuese, ai është miratuar nga secili partner kombëtar. Në të gjitha anketat është përdorur intervista ballë-për-ballë, qoftë *PAPI* ose *CAPI*, për mbledhjen e të dhënave. Së bashku me pyetësorin, është zhvilluar një grup i plotë i mjeteve të përbashkëta, posaçërisht për këtë anketë, të tilla si udhëzuesi për intervistues, libri i kodeve dhe mjete të tjera operative për punën në terren. Në të gjitha fazat, janë ndjekur standarde të rrepta statistikore, duke përfshirë masat për mbrojtjen e konfidencialitetit të të dhënave, në mënyrë që të sigurohet cilësia më e lartë e mundshme e të dhënave.

Puna në terren është kryer nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ndërmjet 20 shtatorit 2012 dhe 30 tetorit 2012. ASK-ja ka organizuar trajnimin e intervistuesve dhe ka mbikqyrur tërë procesin e mbledhjes së të dhënave, nga kontakti i parë deri te përfshirja e të dhënave. Madhësia neto e mostrës ishte 2.000 biznese, nga pesë sektorët kryesorë ekonomikë, të cilat së bashku numërojnë 79.7% të të gjitha bizneseve në vend. Mostra është e shtresuar sipas sektorit ekonomik dhe katër madhësive të kompanisë (mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha).

Popullsia e synuar përfshin bizneset aktive të të gjitha madhësive. Dizajni i mostrës së përdorur për këtë anketë është një mostër e rastit e thjeshtë e shtresuar. Shtresa të ndryshme nga të cilat janë nxjerrë njësitë iu referohen pesë sektorëve kryesorë ekonomikë, sipas NACE Rev 2: Prodhimi industrial, furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë (sektorët C, D, E); Ndërtimtari (sektori F); Tregtia me shumicë dhe tregtia me pakicë dhe Riparimi i automjeteve motorike dhe motoçikletave (sektori G); Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit (sektori I) dhe Transporti e magazinimi (sektori H), si dhe nga 4 kategori të madhësisë së kompanive të biznesit: mikro (1-9 persona të punësuar); i vogël (10-49 persona të punësuar); i mesëm (50-249 persona të punësuar) dhe i madh (më shumë se 250 persona të punësuar).

Rregulla e parë, që është marrë në konsideratë për procedurën e marrjes së mostrës, ishte që për bizneset e mëdha dhe të mesme, numri minimal (neto) i bizneseve për madhësi të biznesit dhe për sektor, duhej të ishte 40 biznese. Në ata sektorë, ku numri i bizneseve të mëdha të (250 + të punësuar) është më i vogël se 40, të gjitha njësitë në kornizë përfshihen në mostër.

Në rastin e entiteteve të biznesit me njësi të shumta lokale të biznesit, intervista është adresuar në zyrën kryesore të kompanisë dhe të gjitha pyetjet në anketë i referoheshin veprimtarive të entitetit, në të gjitha lokalet e asaj kompanie të biznesit. Bizneset me një të punësuar (duke përfshirë të vetë-punësuarit) në përgjithësi janë përjashtuar nga mostra, përveç rasteve kur është treguar ndryshe.

Lidhur me pyetjet për viktimizimin nga krimi, pesë llojet e krimet, të mbuluara në anketë, janë definuar në pyetjet e anketës si vijon:

1. Vjedhje me thyerje: “a ka thyer dhe hyrë ndokush në ndonjë nga lokalet e entitetit të biznesit tuaj me qëllim për të vjedhur diçka, pa ardhur në kontakt me askënd në lokale (pronarët, të punësuarit ose konsumatorët)?”;
2. Vandalizëm: “a është dëmtuar qëllimisht ndonjë pjesë e ndonjërës prej ndërtesave, që i përkasin entitetit tuaj: pajisjeve, automjeteve ose pasurive, që i përkasin entitetit tuaj në lokalet e tij? PËRFSHIJ, për shembull, dëmtimin me forcë, zjarrëvënien ose grafitet. MOS PËRFSHIJ, ndonjë dëmtim që është si pasojë e llojeve të tjera të krimet (p.sh. thyerjen për t'u futur në lokale)”;
3. Vjedhja e automjeteve: “a është vjedhur ndonjë automjet motorik (automobil/furgon/kamion/autobus, ose automjet tjetër motorik) në pronësi ose i marrë me qira nga entiteti juaj, kur askush nuk ishte në automjet?”;
4. Mashtrimi nga të jashtmit: “a e ka mashtruar biznesin ndonjë i jashtëm, siç është distributori, klienti ose furnizuesi, duke fituar avantazh financiar, ose duke shkaktuar humbje me mashtrim implicit ose eksplicit (p.sh. konsumatorët mashtrojnë lidhur me gatishmërinë e tyre për të paguar çmimin e dakorduar; shpërndarësit dhe furnizuesit mashtrojnë lidhur me cilësinë ose sasinë e mallrave/shërbimeve të ofruara)? (PËRFSHIJ mashtrimin, duke përdorur rrjetin elektronik të komunikimit ose sistemin elektronik të informimit)”;
5. Zhvatja: “a ka provuar ndokush të marrë para ose përfitime të tjera nga entiteti i biznesit, duke kërcënuar dhe/ose duke frikësuar menaxherët dhe/ose të punësuarit që punojnë për entitetin tuaj të biznesit, duke përfshirë edhe kërcënimet për dëmtimin e pronës ose për t'i dëmtuar/kontaminuar produktet, ose duke ofruar “mbrojtje” informale kundër dëmeve të tilla?”.

Një përmbledhje e karakteristikave të anketës në Kosovë është dhënë në Tabelën 3.

Tabela 3 Karakteristikat kryesore të anketës në Kosovë (2012)

Karakteristikat e anketës	
Agjencia përgjegjëse	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Periudha e anketës	20 shtator deri më 30 tetor 2012
Dizajni i mostrës	Nxjerrja e mostrës është bërë duke zgjedhur bizneset rastësisht sipas shtresave. Shtresimi është bërë sipas sektorit të biznesit dhe numrit të të punësuarve. Korniza e mostrës është krijuar nga Regjistri Statistikor i Bizneseve të Kosovës (RSB), që rezulton nga kombinimi i të dhënave nga të dy burime: atë statistikore (anketat) dhe burimet administrative (Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës), të trajtuara me metodologji statistikore. Sektori ekonomik është domeni kryesor. Në çdo sektor, numri i përzgjedhur i bizneseve ishte proporcional me numrin e bizneseve ekzistuese sipas madhësisë.
Përzgjedhja e të intervistuarve	Personi i parë përgjegjës për menaxhimin e biznesit.
Metoda e mbledhjes së të dhënave	PAPI - Intervistë me letër dhe laps.
Masat për kontrollin e cilësisë	Kontrollet gjatë anketës, 15% të bizneseve. Kontrollet logjike dhe profesionale në çdo pyetësor. Kontrollet gjatë futjes së të dhënave përmes softuerit specifik. Validiteti, gama e shtrirjes, dyfishimi dhe redaktimi i konsistencës në bazën e të dhënave
Madhësia neto e mostrës	2,000
Shkalla e përgjigjes	82.9



Shtojca III: Treguesit kryesorë

Tabela 4 Treguesit kryesorë sipas sektorit, në Kosovë dhe në rajoni i Ballkanit Perëndimor (2012)

Treguesi	Sektori ekonomik					
	Prodhimi industrial	Ndërtimtaria	Transporti	Akomodimi	Tregtia	Totali
Norma e kontaktimit (Kosovë)	89.7%	93.2%	89.8%	87.7%	92.1%	91.2%
Norma e kontaktimit (Ballkan Perëndimor)	66.8%	72.2%	76.4%	72.4%	72.0%	71.3%
Përhapja e ryshfetit (Kosovë)	4.8%	1.6%		2.9%	3.3%	3.2%
Përhapja e ryshfetit (Ballkan Perëndimor)	9.2%	11.3%		9.0%	10.3%	10.2%
Madhësia mesatare e ryshfetit (Kosovë, në EUR-PFB)	2,033		1,624			1,787
Madhësia mesatare e ryshfetit (Ballkan Perëndimor, në EUR-PFB)	910		866			881
Përhapja e ryshfetit biznes-mebiznes (Kosovë)	1.2%		0.5%			0.6%
Përhapja e ryshfetit biznes-mebiznes (Ballkan Perëndimor)	5.6%		3.2%			4.0%

Treguesi	Sektori ekonomik					
	Prodhimi industrial	Ndërtimtaria	Transporti	Akomodimi	Tregtia	Totali
Përhapja e vandalizmit (Kosovë)	2.2%	2.9%	4.5%	4.5%	3.1%	3.2%
Përhapja e mashtrimit (Kosovë)	9.7%	5.2%	2.6%	5.6%	9.2%	8.0%
Shkalla e raportimit të vjedhjes me thyerje në polici (Kosovë)	89.3%	76.5%	86.6%	78.7%	82.9%	83.0%
Shkalla e raportimit të vandalizmit në polici (Kosovë)	65.6%	73.7%	100.0%	66.9%	70.7%	72.0%
Shkalla e raportimit të mashtrimit në polici (Kosovë)	13.5%	31.1%	23.3%	29.3%	19.0%	19.6%
Përqindja e bizneseve që përdorin ndonjë lloj të masave të sigurisë	75.2%	63.7%	67.9%	76.1%	86.4%	80.4%
Përqindja e bizneseve që kanë ndonjë polisë sigurimi kundër krimit	24.9%	22.9%	36.0%	43.9%	34.4%	33.3%

Shënim: Përhapja e ryshfetit është llogaritur si numri i bizneseve, që i kanë dhënë një zyrtari publik para, dhuratë ose kundërfavor, në të paktën një rast, në 12 muajt para anketës, si përqindje e bizneseve që në të njëjtën periudhë kishin të paktën një kontakt me një zyrtar publik. Normat vjetore të përhapjes për mashtrim nga të jashtmit, vjedhje me thyerje dhe vandalizëm janë llogaritur përkatësisht si numri i kompanive, që janë sprovuar me secilin prej këtyre krimeve, si përqindje e numrit të përgjithshëm të kompanive. Normat e raportimit për ryshfet i referohen herës së fundit të sprovimit me ryshfet, në 12 muajt para anketës, të raportuar tek autoritetet zyrtare; për forma të tjera të krimit, normat e raportimit i referohen krimit të fundit të sprovuar në tri vitet e fundit dhe të raportuar në polici. EUR-PFB është vlerësuar në bazë të vlerësimeve WIIW.